



Ethics

FORCIMI I INTEGRITETIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE NË SHQIPËRI

Analizë e kuadrit mbi etikën që rregullon sjelljen
e nëpunësve publikë në Shqipëri

Arjan Dyrmishi

Mirsada Hallunaj



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-te
Postal Code 1418
Tirana, Shqipëri

Autorët: Arjan Dyrmishi
Mirsada Hallunaj

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Përmbajtja

Shkurtime dhe Akronime	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	7
1. Qasjet ndaj Menaxhimit të Etikës	9
1.1 Aplikimi i sistemeve të etikës dhe qasjet rregullatore	11
1.2 Menaxhimi i etikës dhe administrimi publik	12
2. Fillimet e Etikës në Shërbimin Publik në Shqipëri	14
2.1 Instrumentet ligjore ndërkombëtare mbi etikën	14
2.2 Nismat dhe instrumentet ligjore për zhvillimin e etikës në shërbimin publik në Shqipëri	17
3. Kuadri Aktual mbi Etikën në Shqipëri	22
3.1 Kodet e etikës të miratuara me ligj	22
3.2 Kodet institucionale ose profesionale të etikës	25
4. Zbatimi dhe praktika e kuadrit etik	36
4.1 Kuadri institucional	36
4.1.1 Departamenti i Administratës Publike	36
4.1.2 Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	37
4.2 Infrastruktura etike	39
4.2.1 Trajnime mbi etikën	39
4.2.2 Komunikimi i vlerave ose primeve themelore etike	40
4.2.3 Rekrutimi	41
4.2.4 Krijimi i strukturave etike	28
4.3 Zbatimi i kodeve të etikës	42
4.3.1 Zbatimi i kodeve të etikës miratuar me ligj	42
4.3.2 Zbatimi i kodeve institucionale ose profesionale të etikës	44
5. Konkluzione dhe rekomandime	48
Bibliografia	52
Shtojca	59
Shtojca 1: Legjislacioni për etikën në Shqipëri	59
Shtojca 2: Kodet e etikës së praktikës profesionale	61

Shkurtime dhe Akronime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi European
DAP	Departamenti i Administratës Publike
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
RESPA	Shkolla Rajonale e Administratës Publike
SHC	Shërbimi Civil

Tabela

Tabela 1:	Instrumentet dhe standardet kryesore ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe promovimit të etikës
Tabela 2:	Kodet e Etikës miratuar në Shqipëri nga viti 1999
Tabela 3:	Kuadri normativ mbi transparencën, paanësinë, jo-diskriminimin që rregullon veprimet dhe sjelljen e nëpunësve publikë në Shqipëri
Tabela 4:	Trajnime mbi Etikën, Konfliktin e Interesit dhe Korrupsionon, të zhvilluara në vitin 2014
Tabela 5:	Masat Disiplinore për nëpunësit civilë për periudhën 2003-2013

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë dy dekadave të fundit, shumë vende Perëndimore, por edhe vende të Evropës Qendrore dhe Lindore kanë ndërmarrë reforma të rëndësishme në administratën publike, përfshirë dhe çështjet mbi etikën dhe integritetin, të cilat u ndikuan në këtë mënyrë nga ndryshimet themelore në sistemet e administratës publike.

Në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, etika ishte një çështje që u shfaq në fillim të viteve 2000, duke qenë se u miratuan kode të cilat synonin të adresonin probleme të etikës. Kodi i Shërbimit Publik të Etikës në Estoni, i miratuar në vitin 1999, ishte kodi i parë i ndër vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore; më tej edhe vendet e tjera miratuan gjithashtu kodet e tyre të etikës.¹

Edhe në Shqipëri janë bërë përpjekje për të përfshirë parime të etikës, krahas reformave të tjera që kishin për qëllim ndërtimin e një administrate publike të depolitizuar, efikase dhe të pakorruptuar. Që nga viti 1999 dhe në vazhdim janë miratuar kode të etikës nga segmente të ndryshme të administratës publike në nivel qendror dhe lokal, si pjesë e përpjekjeve për ndërtimin e integritetit.

Megjithatë rezultatet e këtyre përpjekjeve kanë qenë të përziera dhe etika në administratën publike shqiptare nuk ka arritur deri më tash të jetë një mjet plotësisht efektiv kundër korrupsionit. Me gjithë miratimin e një numri kodesh etike, niveli i zbatimit dhe vlera praktike e kodeve të miratuara në përgjithësi është e dobët.

Faktorët kryesorë që kanë të bëjnë me këtë situatë përfshijnë (1) mungesën e kuptimit të qartë mbi etikën, e cila konsiderohet si një normë që shpesh mbivendoset me ligje dhe rregulla të tjera ekzistuese, (2) kufizimin e përpjekjeve me thjesht miratimin e kodeve të etikës dhe mungesën e infrastrukturës së

¹ Palidauskaite, J. Codes of Ethics in Transitional Democracies: A Comparative Perspective. Public Integrity, Vol. 8, No 1, 2005, 35 - 48.

nevojshme për zbatimin e saj.

Disa prej kodeve japin pohime të përgjithshme mbi parimet e etikës, pa dhënë objektiva të qarta, specifitime në lidhje me një profesion të caktuar apo detyrime dhe ndëshkime, ndërsa kode të tjera për shkak të miratimit të tyre me ligj janë të detyrueshme dhe parashikojnë ndëshkime.

Një aspekt tjetër që zbulon qasjen e fragmentuar ndaj etikës është mungesa e një kodi etik në nivel kombëtar, që do të mbulonte personat e zgjedhur ose emëruar të nivelit të lartë, të tillë si p.sh. deputetë, ministra, drejtues të institucioneve dhe agjencive të pavarura që nuk i përkasin kategorisë së nëpunësve civilë.

Përveç mungesës së qartësisë në përcaktimin e etikës ekziston edhe një mungesë e dukshme e organeve apo strukturave përgjegjëse për zbatimin e etikës dhe promovimin e standardeve etike. Kjo mangësi e bën pothuajse të pamundur për t'u informuar mbi zbatimin e etikës dhe ndikimin e saj në procesin e ndërtimit të integritetit të administratës publike.

Si pasojë, përfundimi kryesor i këtij studimi është se pavarësisht faktit që Shqipëria ka bërë përpjekje për ndërtimin e etikës nëpërmjet miratimit të një numri të kodeve të etikës, mekanizmat që do të siguronin një zbatim efikas të tyre mungojnë duke çuar kështu në një menaxhimin në përgjithësi të dobët të etikës.

Në mënyrë që të adresohen mangësitë e identifikuarra, ky studim rekomandon themelimin e një organi në nivel kombëtar, përgjegjës për zbatimin dhe promovimin e integritetit dhe standardeve etike.

Kuadri normativ mbi etikën ka nevojë të rivlerësohet dhe rishikohet në mënyrë që të sigurojë një kuptim më të qartë mbi rolin e etikës dhe të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e një infrastrukture etike efektive. Etika duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe për zyrtarët e nivelit të lartë duhet të miratohet një kod etike, si një standard ndërkombëtar dhe një mjet i rëndësishëm kundër korrupsionit.

Hyrje

Pas rënies së komunizmit dhe fillimit të tranzicionit demokratik reforma e administratës publike në Shqipëri ka qenë një element kyç i qeverisjes demokratike.

Në përgjigje të përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të miratuar standarde ligjore si një mjet për luftimin e korrupsionit dhe ryshfetin e zyrtarëve publikë, në Shqipëri janë miratuar një numër kodesh etike duke filluar nga fundi i viteve 1990 dhe fillimi i viteve 2000.

Megjithatë pavarësisht nga përhapja e kodeve të etikës dhe ndikimit të tyre në segmente të ndryshme të administratës publike, nuk ka pasur deri më sot ndonjë vlerësim mbi mënyrën se si këto kode kanë kontribuar në ndërtimin e etikës dhe integritetit në administratën publike shqiptare.

Kundrejt këtij sfondi ky studim ofron një vlerësim të kuadrit etik në administratën publike shqiptare, duke shqyrtuar kushtet në mjedisin ndërkombëtar dhe kombëtar që kanë shpënë në miratimin e kuadrit normativ dhe institucional mbi etikën në Shqipëri, si dhe të infrastrukturës për zbatimin e etikës.

Objektivi kryesor i këtij punimi është të identifikojë progresin e bërë në këtë drejtim, si dhe të vlerësojë boshllëqet dhe mangësitë dhe të paraqesë rekomandime për përmirësim.

Punimi është i ndarë në katër seksione kryesore. Seksioni i parë ofron një pasqyrë në lidhje me qasjet ndaj etikës dhe pajtueshmërinë e tyre me sisteme të caktuara të administratës publike në nivel ndërkombëtar. Në këtë seksion janë përshkruar gjithashtu qasjet e përgjithshme ndaj menaxhimit të etikës dhe zbatimit të tyre si edhe disa veçanti të disa administratave publike.

Seksioni i dytë diskuton fillimisht instrumentet e miratuara nga komuniteti ndërkombëtar për të vendosur standarde rajonale dhe ndërkombëtare dhe

për të zhvilluar dhe ruajtur standarde dhe vlera të larta të etikës dhe sjelljes në administratën publike. Më pas, ky seksion analizon hapat e ndërmarra nga Shqipëria për të adoptuar kuadrin normativ mbi etikën dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Pjesa e tretë analizon më nga afër kuadrin normativ mbi etikën dhe ofron një vlerësim të kodeve të etikës të miratuar deri tani, duke analizuar qasjen normative ndaj etikës, infrastrukturën përkatëse të parashikuar nga kodet e miratuara, kuadrin institucional për brendësimin e etikës si dhe ndikimin në qasjen ndaj etikës.

Seksioni i katërt fokusohet në analizën e infrastrukturës etike duke shqyrtuar elemente të tilla si komunikimi, rekrutimi, trajnimi dhe ngritja e organeve të etikës.

Pjesa e fundit ofron disa vërejtje përmbyllëse dhe rekomandime për përmirësimin e standardeve etike në Shqipëri.

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metoda kërkimore e rastit studimor ndërsa të dhënat e përdorura janë sasiore dhe cilësore. Të dhënat e mbledhura përfshijnë legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme, si dhe intervista dhe fokus grupe për të vlerësuar nivelin e brendësimit të kodeve të etikës.

1. Qasjet ndaj menaxhimit të etikës

Ekzistojnë dy qasje të cilat konsiderohen se ndikojnë në nxitjen e etikës në agjencitë publike: “the high road” dhe “the low road”. Sipas John Rohr “high road” thekson barazinë sociale. “Duke u bazuar në karakterin moral, kjo qasje mbështetet tek menaxherët e etikës si individë për të reflektuar, vendosur dhe vepruar. Përgjegjësia individuale është pika e fillimit dhe e mbarimit në rrugën drejt forcimit të integritetit në shërbimin publik”.² Rohr shqyrton qasjet etike bazuar në filozofinë politike, veçanërisht në teorinë e Drejtësisë së J. Rawls, në psikologjinë humane dhe në vlerat e sistemit. Ai sugjeron që metoda e “vlerave të sistemit” është më e përshtatshme për integrimin e etikës në një kurrikulum të administratës publike.³

Ndryshe nga qasja “high road”, e cila refuzon realitetet administrative që burojnë nga llogaridhënia,⁴ qasja “low road” i adreson çështjet etike pothuajse ekskluzivisht nëpërmjet respektimit të rregullave të agjencisë. Sipas kësaj qasjeje “sjellje etike përmbledhet në zbatimin e rregullave për të mos patur telashe”.⁵ “Low road”, ka në fokus respektimin e rregullave formale, standardeve të zbatueshme ligjërisht dhe zgjidhjes së problemeve. “Low road” parashikon përmbushjen e një minimumi standardesh të sjelljes dhe respektimin e kufizimeve ligjore.

Qasjet analoge dihomike janë “pajtueshmëria”, “integriteti” dhe “verifikimi”, “vlerat” të krijuara për të vendosur integritetin e institucioneve.⁶ Qasja e pajtueshmërisë me rregullat thekson rëndësinë e kontroleve të jashtme në

2 Lewis C.W., Gilman, S.C. The Ethics Challenge in Public Service. Jossey-Bass, 2005, pp 16-17.

3 Rohr, J.A. Ethics for Bureaucrats. An Essay on Law and Values. Marcel Dekker Inc., 1989, pp 68.

4 Lewis C.W., Gilman, S.C. The Ethics Challenge in Public Service. Jossey-Bass, 2005, pp 17.

5 Ibid, pp 62

6 Maesschalk, J. Approaches to Ethics Management in the Public Sector. A Proposed Extension of the Compliance-Integrity Continuum. Public Integrity, Vol.7, No. 1, 2004, 21 - 42.

formësimin e sjelljen së nëpunësve publikë.

Lewis dhe Gilman ofrojnë një qasje të tretë (ata përdorin një term modernist 'fuzioni') që përfshin pajtueshmërinë me standardet formale dhe promovimin e përgjegjësisë etike individuale. Karakteri i pamjaftueshëm dhe problemet e vazhdimësisë së dyfishtë çojnë Jeroen Maesschalk të propozojë një zgjerim të vazhdimit - bazuar në teorinë e rrjetëzimit të grupit.⁷ Qasja e tij jep mundësi të reja për të klasifikuar sistemeve ekzistuese të menaxhimit të etikës në administratën publike dhe për të përpunuar zgjidhje efektive për probleme konkrete. Nga ana tjetër, ajo në thelb mbetet në fushën e qasjes dualiste.

Karakteristikat e kuadrit etik janë përshkruar dhe paraqitur nga organizatat ndërkombëtare si Bashkimi Evropian dhe OECD.⁸ Kuadri etik ose infrastruktura etike përqendrohen në elementet ose karakteristika të cilat shtetet anëtare i konsiderojnë të rëndësishme për funksionimin e duhur të shërbimit publik. Ka dallime në ato dokumente, por disa nga idetë më të rëndësishme të tilla si nevoja për standarde të qarta etike apo vlerash, rëndësia e lidershit, trajtimi i keqsjelljes, shmangia e konfliktit të interesave, janë të njëjta.

Si rezultat i ndikimit të metodave të reja të menaxhimit të sektorit private të zbatuara në sistemet dhe menaxhimin e shërbimeve publike, vende të ndryshme kanë aplikuar metoda të reja të menaxhimit publik dhe kanë trajtuar sfidat në fushën e etikës në mënyra të ndryshme. Për pasojë, shumë vende evropiane kanë riorientuar kërkesat etike në këtë realitet që evoluon duke rishqyrtuar vlerat e tyre kryesore ose parimet udhëzuese të shërbimit publik.

Kështu, vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore kanë miratuar modele të ndryshme të menaxhimit etik. Këto vende kanë miratuar kodet e tyre të etikës në fillim të viteve 2000, përfshirë edhe Shqipërinë. Në shumicën e këtyre vendeve kodet ofrojnë një listë të hollësishme të parimeve dhe rregullimet administrative dhe janë hartuar si ligje.⁹ Në bazë të rezultateve dhe vëzhgimeve në rritje nga analizat e bëra në këto vende, çështjet dhe shqetësimet e zbatimit të etikës në administratën publike vazhdojnë që në një masë të madhe të mbeten pa përgjigje.

Siç u diskutua më sipër, në të gjitha vendet e lartpërmendura elementet e infrastrukturës etike ekzistojnë, por ato janë miratuar dhe zhvilluar ndryshe.

7 Maesschalk, J. Approaches to Ethics Management in the Public Sector. A Proposed Extension of the Compliance Integrity Continuum. Public Integrity, Vol.7, No. 1, 2004, 21 - 42.

8 Building Public Trust: Ethics Measures on OECD Countries. PUMA Policy Brief, OECD, No. 7, 2000; Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996; Main features of an Ethics Framework for the Public sector. European Union, 2004; Principles for Managing Ethics in the Public Service, PUMA Policy Brief, OECD, No. 4, 1998.

9 Palidauskaitė, J. Codes of Ethics in Transitional Democracies: A Comparative Perspective. Public Integrity, Vol. 8, No 1, 2005, pp 38.

Shqetësimi kryesor në lidhje me praktikën e zbatimit të etikës varet se si janë shprehur kërkesat dhe vlerat e përgjithshme.

Duke marrë parasysh lidhjen ndërmjet sistemit etik të një vendi dhe qasjen ndaj menaxhimit publik, pjesa më poshtë shqyrton aplikimin e sistemeve të ndryshme të etikës.

1.1. Aplikimi i sistemeve të etikës dhe qasjet rregullatore

Kodi ofron një listë të hollësishme të parimeve. Rregullat e etikës janë të dizajnuara si kategori ligjore dhe vlera e rregullimit të sjelljes etike të nëpunësve publikë është i lidhur ngushtë me elementin e detyrimit. Kështu, etika si kuadër normash bëhet e detyrueshme për këdo që është subjekt i rregullave normative nëpërmjet miratimit të një sërë aktesh normative dhe kodeve të etikës.

Për vendet që kanë shprehur kërkesat e tyre etike në rregullat (kode të etikës), janë të nevojshme edhe mekanizmat për zbatimin e këtyre rregullave. Prandaj, kur detyrimet dhe vlerat thelbësore janë të shprehura në legjislacion, pajtueshmëria bëhet një kërkesë ligjore. Qasja ndaj rregullave apo ligjit nënkupton dy qasje të ndryshme në lidhje me kuadrin rregullues.

I pari i referohet qasjes 'pajtueshmërisë' që përdor masa që përjashtojnë ndjekjen penale. E dyta mbështetet tek 'parandalimi' dhe përdor sanksionet penale në rast të dështimit për t'iu përmbajtur ligjit.¹⁰ Kjo është e rëndësishme për shkak se kodet apo deklaratat e vlerave mund të ndihmojnë për të kuptuar më mirë qasjen e një qeverie ndaj etikës.

Në vendet ku nuk ekziston një organ qendror koordinues për etikën dhe ku përgjegjësia e etikës është lënë në dëshirën individuale të nëpunësve publikë, qasja ndaj integritetit është ndërtuar mbi bazën e vlerave që synohen për sektorin publik, dhe ndonjëherë e plotësuar me kode të decentralizuara të sjelljes.¹¹

E dyta i referohet qasjes së pajtueshmërisë në menaxhimin e etikës që fokusohet në përputhshmërinë e plotë me procedura administrative dhe rregulla të detajuara, të cilat përcaktojnë se çfarë nëpunësit publikë duhet të bëjnë dhe si.¹² Në këtë qasje zakonisht nuk ka asnjë dallim midis mënyrës se si shprehen rregullat, nëse ato

10 Hunt, M. Ethics and British Local Government: The Relevance of Compliance Strategies. Paper presented to the international conference 'Ethics and Integrity of Governance', Leuven, 2005 http://soc.kuleuven.be/io/ethics/paper/Paper%20WS1_pdf/Michael%20Hunt.pdf

11 Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996, pp 61.

12 Ibid.

janë të përfshira në ligjet apo të vendosur si rregulla më vete apo kode të sjelljes.

Shumë vende kanë shfaqur tendencën për tu larguar nga sistemi i bazuar tek ligji ose rregullat drejt sistemit të bazuar tek vlerat. “Në aspektin e zhvillimit të një regjimi të etikës, pyetja që shtrohet është nëse mund të shkohet direkt në një sistem të bazuar tek integriteti apo nëse një sistem i bazuar tek rregullat është një fazë e domosdoshme kalimtare”.¹³ Krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore që kanë filluar të krijojnë kodet e tyre të etikës kohët e fundit dhe që nuk kanë një qasje për etikën të bazuar në rregulla, në Evropën Qendrore dhe Lindore ka një tendencë më të madhe për të krijuar kode të hollësishme të sjelljes të plotësuar me masa ndëshkuese.

1.2. Menaxhimi i etikës dhe administrimi publik

Në fushën e administrimit publik ekzistojnë dy tradita kryesore të njohura: ‘Administrimi i Vjetër Publik’ dhe ‘Menaxhimi i Ri Publik’. “Menaxhimi i Ri Publik’ i referohet një grupi idesh dhe praktikash që në thelbin e tyre synojnë të përdorin sektorin privat dhe qasjet e biznesit në sektorin publik”.¹⁴ “Ndërsa në vitet 1980 ‘Menaxhimi i Ri Publik’ ishte përqendruar kryesisht në promovimin e një shërbimi shtetëror më efikas dhe më efektiv, në vitet 1990 u përfshinë edhe çështje të tilla si paanësia, integriteti dhe kështu me radhë. Kjo u konceptua si “qeverisje e mirë”.¹⁵ Në fakt, qasja ndaj menaxhimit publik është e rëndësishme për të analizuar etikën, sepse ajo ofron sinjale se në cilin drejtim duhet të zhvillohen regjimet e etikës.¹⁶ Ndryshimet në sistemin e administratës publike kanë ndikuar në rritjen e problemeve etike në shërbimin publik.¹⁷ Në pjesën më të madhe të vendeve evropiane ndryshimet që kanë shoqëruar lëvizjen drejt manaxherializmit dhe ‘Menaxhimit të Ri Publik’ kanë patur një ndikim të madh.

Duke i parë çështjet e etikës nga perspektiva e sistemit të administratës publike bëhet më se e qartë se përzgjedhja e mjeteve të menaxhimit të etikës duhet të

13 Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996, pp 61.

14 Denhardt, R. B., Denhardt J. V. The New Public Service: Serving Rather than Steering. Public Administration Review, Vol. 60, No. 6, 2000, 549 – 559; pp 550

15 Bekke, H., van der Meer, F. Civil Service Systems in Western Europe. Edward Elgar Pub, 2000, pp 9.

16 Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996, pp 61.

17 Civil Service Reform in Europe. Report, Doc. 9711, Parliamentary Assembly, Committee on Economic Affairs and Development, Rapporteur: Mr Giovanni Crema, COE, 2003. Demmke, Ch. and Bossaert, D. (Responsible for the study). Survey “Ethics in the Public Services of the European Union Member States”. Collaboration Between the Irish and Dutch Presidencies, European Union / European Institute of Public Administration, 2004, pp. 50.

përshatatet me kushte të caktuara. Ka disa tregues të cilët tregojnë se menaxhimi i etikës bazuar mbi integritetin përshatatet me stilin e 'Menaxhimit të Ri Publik', ndërsa qasja e pajtueshmërisë nuk i përshtatet qasjes menaxheriale e cila bazohet tek rezultatet.¹⁸

18 Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996.

2. Fillimet e etikës në shërbimin publik në Shqipëri

2.1. Instrumentet ligjore ndërkombëtare mbi etikën

Në mesin e viteve 1990 dhe në fillim të viteve 2000 bashkësia ndërkombëtare filloi të vendosë standarde rajonale dhe ndërkombëtare dhe të tërheqë vëmendjen e vendeve për të zhvilluar dhe ruajtur standarde dhe vlera të larta si dhe etikë dhe sjellje në administratën publike, si mjete për të luftuar korrupsionin, veçanërisht për të parandaluar ryshfetin për zyrtarët publikë (Tabela 1).

Gjatë kësaj periudhe ka pasur një nevojë të madhe për zbatimin e këtyre standardeve dhe instrumenteve të tjera ligjore, të cilat çuan në ndryshime të rëndësishme në institucionet ekzistuese dhe strukturat e tyre organizative. Të gjithë aktorët nga qeveria tek sektori privat dhe shoqëria civile u përballën me këto sfida në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal.

Këto standarde u përçuan nga konventa si Konventa Ndëramerikane Kundër Korrupsionit (1996); Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD); Konventa kundër Ryshfetit (1997); Konventat Penale dhe Civile të Këshillit të Evropës (1999); Konventa e Unionit Afrikan për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit (2003) dhe Konventa Kundër Korrupsionit e OKB-së (2003).

Karakteristikat të kuadrit etik u prezantuan edhe nga organizata ndërkombëtare si Bashkimi Evropian dhe OECD.¹⁹ Këto korniza parashikuan gjithashtu edhe termat e infrastrukturës etike si 'një tërësi mjetesh dhe të procesesh për të evituar sjellje të padëshiruar dhe/ose dhënien e stimujve për të inkurajuar sjelljen e mirë të

¹⁹ Building Public Trust: Ethics Measures on OECD Countries. PUMA Policy Brief, OECD, No. 7, 2000; Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996; Main features of an Ethics Framework for the Public sector. European Union, 2004; Principles for Managing Ethics in the Public Service, PUMA Policy Brief, OECD, No. 4, 1998.

zyrtarëve publikë”.²⁰

Kuadri mbi etikën ose infrastruktura etike përqendrohet në elementet ose aspekte të cilat shtetet anëtare i konsiderojnë të rëndësishme për funksionimin e duhur të shërbimit të tyre publik. Në këto dokumente ekzistojnë dallime, por idetë kryesore siç janë, nevoja për standarde apo vlera të qarta etike, rëndësia e leadershipit, trajtimi i keqsjelljes, shmangia e konfliktit të interesit, janë të njëjta. Ato janë në përgjithësi instrumente ose mekanizma të rekomanduara, ekzistenca e të cilave mund të mos thojë asgjë në lidhje me efektivitetin e tyre në etikën e një shërbimi publik të caktuar.

Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes së Nëpunësve Publike miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1996,²¹ dhe Kodet Model të Sjelljes për Nëpunësit Publikë të zhvilluara nga Këshilli i Evropës dhe miratuara nga Shtetet Anëtare në 2000,²² shërbejnë si një pikë reference dhe një model për shumë administrata shtetërore. Ato synojnë të vendosin një precedent për vendet në mënyrë që të hartojnë kodet e tyre të detyrueshme të sjelljes. Shumë prej standardeve janë të njëjta me ato të Kodit të Sjelljes së Kombeve të Bashkuara, por teksti i Këshillit të Evropës shkon më tej sa i përket aspekteve të shërbimit publik të lidhura me masat dhe politikat anti-korrupsion.

Kodi Model i Këshillit të Evropës zbatohet për të gjithë nëpunësit publikë (që do të thotë personat e punësuar nga një autoritet publik), dhe çdo nëpunës publik ka për detyrë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të përmbushur dispozitat e kodit. Qëllimi i kodit është të përcaktojë standardet e integritetit dhe sjelljes që duhen respektuar nga nëpunësit publikë, t'i ndihmojë ata të përmbushin këto standarde dhe të informojë publikun mbi sjelljen që publiku kanë të drejtë të presë nga zyrtarët e tij publikë.

Ndërkohë koncepti i integritetit është identifikuar nga vendet anëtare të OKB-së, kolektivisht dhe individualisht, si pjesë e parimeve themelore të administratës publike.²³ Në administratën publike, integriteti i referohet “ndershmërisë” ose “besueshmërisë” në kryerjen e detyrave zyrtare, duke shërbyer si një antitezë e “korrupsionit” ose “shpërdorimit të detyrës”.

20 Organization for Economic Cooperation and Development (OECD) (1996) Ethics in Public Service, Paris: OECD.

21 Shiko: www.un.org/documents/ga/res/51/a51r059.htm Shiko gjithashtu raportin “Implementation of the International Code of Conduct for Public Officials” nga Këshilli Social dhe Ekonomik i OKB, në: <https://www.unodc.org/pdf/crime/commissions/11comm/6add1e.pdf>

22 Shiko: [www.coe.int/t/dg1/greco/documents/Rec\(2000\)10_EN.pdf](http://www.coe.int/t/dg1/greco/documents/Rec(2000)10_EN.pdf)

23 Karta e OKB-së deklaron, “Konsiderata kryesore në punësimin e stafit (OKB) ... do të jetë nevoja për të siguruar standarde më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit.” (Neni 101) Përveç kësaj, shumë Shtete Anëtare duhet të identifikojnë në kushtetutat e tyre dhe ligjet përkatëse, integritetin, transparencën dhe llogaridhënien ndërmjet vlerave themelore ose parimeve themeluese për administratat e tyre publike.

Koncepti i Transparency International (TI) për një sistem kombëtar të integritetit gjithashtu përshkruan institucionet kryesore pjesë përbërëse në luftën kundër korrupsionit. Nëntë “shtyllat” e sistemit përfshijnë ekzekutivin, shoqërinë civile, sektorin privat, kampionin e reformës, gjyqësorin, agjencitë e zbatimit, mediat, agjencitë mbikëqyrëse dhe parlamentin. Ato ndikojnë në tre sfera; sundimin e ligjit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e jetës.

Tabela 1: Instrumentet dhe standardet kryesore ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe për promovimin e etikës

Lista e Standardeve Ligjore Ndërkombëtare kundër Korrupsionit dhe promovimit të Etikës	
1996	Konventa Ndëramerikane kundër Korrupsionit Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara - Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Nëpunësit Publikë
1997	Konventa për Luftën kundër Korrupsionit që ka të bëjë me zyrtarët e Komuniteteve Evropiane ose zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian Këshilli i Evropës (Komiteti i Ministrave), Rezoluta (97) 24 Mbi 20 Parimet Drejtuese për Luftën kundër Korrupsionit Konventa për Luftën kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi Komente mbi Konventën për Luftën kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi
1998	Kodi i Etikës & Standardet e Auditimit Rekomandim i Këshillit mbi Përmirësimin e Sjelljes Etike në Shërbimin Publik
1999	Konventa e së Drejtës Penale mbi Korrupsionin Konventa e së Drejtës Civile mbi Korrupsionin (Këshilli i Evropës)
2000	Kodi Model i Sjelljes për Nëpunësit Publikë – Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave
2001	Kodi Evropian i Etikës Policore. Rekomandim Rec(2001)10 miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit Evropian më 19 Shtator 2001 dhe memorandum shpjegues Protokoll i Komunitetit Ekonomik të Shteteve të Afrikës Perëndimore mbi Luftën kundër Korrupsionit

Lista e Standardeve Ligjore Ndërkombëtare kundër Korrupsionit dhe promovimit të Etikës	
2002	Vendim Kuadër i Këshillit mbi Luftën kundër Korrupsionit në Sektorin Privat
2003	Komunikim mbi një Politikë gjithëpërfshirëse të BE kundër Korrupsionit Rekomandime të Këshillit mbi Udhëzimet e OECD për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik Konventa e Bashkimit Afrikan për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 58/4; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) - Menaxhimi i Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik (Udhëzime të OECD dhe Përvojat e Vendeve)
2004	Karakteristikat kryesore të një Kuadri Etik për sektorin Publik. Propozuar nga Presidenca e Holandës dhe miratuar nga Drejtorët e Përgjithshëm, përgjegjës për Administratën Publike në shtetet anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian në takimin e tyre të 43-të në Maastricht (Holandë)
2005	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) Menaxhimi i Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik (Pakoja e Instrumenteve)
2009	Rekomandim i Këshillit për Luftën e Mëtejshme kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi Standardet Ndërkombëtare për të Luftuar Korrupsionin në Forcat/ Shërbimet e Policisë

2.2. Nismat dhe instrumentet ligjore për zhvillimin e etikës në shërbimin publik në Shqipëri

Anëtarësimi në BE ka qenë sfida më e madhe politike dhe shoqërore në Shqipëri për gati dy dekada. Reforma e administratës publike ka përfaqësuar një nga sfidat kryesore të vendit, duke qenë se është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me anëtarësimin në BE. Integrimi në BE kërkon si parakusht krijimin e kapaciteteve të mjaftueshme administrative dhe aftësinë për të miratuar dhe zbatuar legjislacionin e BE-së. Për këtë arsye, reforma në administratën publike ka qenë dhe vazhdon të

mbetet një prioritet për qeverinë shqiptare.²⁴

Për të plotësuar standardet ndërkombëtare dhe respektuar standardet dhe normat e përbashkëta në fushën e etikës, Shqipëria filloi të ndërmarrë hapa për adresimin e çështjeve të etikës duke miratuar legjislacionin përkatës dhe ngritur kapacitetet institucionale.

“Kodi i Etikës së Policisë” ishte dokumenti i parë i miratuar me ligj në vitin 1998 që trajtonte çështje etike. Vite më vonë, në 2003 u miratua Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike. Në të njëjtin vit (2003), u miratua Ligji Nr. 9049, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili në vitin 2005 u plotësua me Ligjin Nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Në sektorin e auditimit nga viti 2012 etika dhe integriteti kanë qenë në fokusin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), i cili në kuadër të strategjisë institucionale ka ndërmarrë hapa në lidhje me promovimin e etikës dhe integritetit. Në vitin 2012 KLSH themeloi Drejtorinë e Hetimit, e cila është përgjegjës për hetimin e shkeljeve të etikës/integritetit nga ana e audituesve dhe e punonjësve të tjerë të stafit të KLSH-së.

Në përgjigje të shtimit të fokusit mbi etikën, nga viti 2011 ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e kodeve të etikës të miratuara nga institucione dhe segmente të ndryshme të administratës publike (Tabela 2).

Tabela 2: 23 Kodet e Etikës miratuar në Shqipëri nga viti 1999

Kodet e Etikës në Shqipëri nga viti 1999	
1999	1. Ligji Nr. 8291, datë 25.02.1998 “Kodi i Etikës së Policisë”
2003	2. Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike
2003	3. Kodi i Etikës i Bankës së Shqipërisë (BSH)
2005	4. Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) 5. Kodi i Etikës së Avokatit
2007	6. Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës (AK) 7. Kodi i Etikës i Bashkisë Bilisht
2008	8. Kodi Etik-Deontologjik i “Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë”

24 Departamenti i Administratës Publike (2013) “Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike” 2013-2020. http://www.pad.gov.al/strategjite%5CSNAP_draft.pdf

Kodet e Etikës në Shqipëri nga viti 1999	
2010	9. Kodi i Etikës së Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë 10. Kodi i Etikës për Ekspertët Kontabël të Regjistruar
2011	11. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore 12. Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës 13. Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm 14. Kodi i Etikës dhe Parimet Bazë të Punës së Vëzhguesit Vendor
2012	15. Kodi i Etikës së Mësuesit në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat 16. Kodi i Etikës së Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2013	17. Kodi i Etikës për Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë
2014	18. Kodi i Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar 19. Kodi Etik i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) 20. Kodi i Etikës i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) 21. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve 22. Kodi Etikës i Spitalit Rajonal Durrës 23. Kodi i Etikës i Universitetit Politeknik të Tiranës

Kohët e fundit janë ndërmarrë disa nisma ligjore për të përmirësuar sjelljen etike në shërbimin publik, duke përfshirë: Ligjin e ri Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 30 prill 2015; “Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020”,²⁵ miratuar nga Këshilli i Ministrave më 15 prill 2015, e cila reflekton drejtimet kryesore të programit qeveritar për administratën publike; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II (SKZHI) 2014-2020,²⁶ organizuar në dy pjesë kryesore. Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Korrupsionit (2014-2017), përgatitur nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit me ndihmën teknike të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri; Ligji i ri Nr. 119/2014 “Për të drejtën e

25 http://www.dap.gov.al/attachments/article/399/ENG_Draft_PAR_Strategy.pdf

26 http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/NSDI_2014-2020_version_JUne-2013.pdf

informimit”, i cili tenton të përmirësojë dhe rregullojë mbrojtjen e së drejtës për informim, siç parashikohet me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, miratuar në Shtator të vitit 2012, të cilat i mundësojnë qeverisë të krijojë një strukturë më koherente të institucioneve publike. Një tjetër nismë e mbështetur nga Ambasada Holandeze në Tiranë, u ndërмор në 2015 për të zhvilluar një projektligj mbi bilbil-fryrësit, i cili ende është në procesin e diskutimeve.

Në Shkurt 2015 qeveria shqiptare prezantoi portalin online anti-korrupsion www.stopkorrupsionit.al për të lejuar qytetarët në mënyrë anonime të regjistrojnë dhe raportojnë rastet e korrupsionit dhe neglizhencës. Portali përmban 12 menu të cilat korrespondojnë me 12 fushat kryesore që mund të çojnë në korrupsion.²⁷ Ky hap është një tjetër përpjekje për t’iu përgjigjur thirrjes së Komisionit Evropian për progresin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i cili thekson se në Shqipëri “korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe mbetet një problem shumë serioz.”²⁸

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr. 119/2014 mbi “Drejtën e Informimit” qeveria shqiptare përgatiti Programin e Transparencës për autoritetet publike. “Programi Model i Transparencës për Autoritetet Publike” është miratuar me Urdhër Nr. 14, datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky program përcakton kuadrin ligjor të veprimtarisë së autoritetit në kontekst të Ligjit Nr. 119/2014 mbi “Drejtën e Informimit”. Tabela 3 paraqet një përmbledhje më të plotë të legjislacionit që ka të bëjë me rregullimin e sjelljes së nëpunësve publikë.

Table 3: The normative framework on transparency, impartiality, non-discrimination that regulates the actions and conduct of Albanian public servants

Legislation Related to Public Servants’ Conduct	
1995	Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”
1999	Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, ndryshuar me Ligjin e ri Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”
	Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (Fletore Zyrtare 19/1999, faqe 578; data e publikimit: 20.07.1999), ndryshuar me Ligjin e ri Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”
	Ligji Nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare” ndryshuar me Ligjin e ri. Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

²⁷ www.stopkorrupsionit.al

²⁸ Albania 2014 Progress Report, faqe 44

Legislation Related to Public Servants' Conduct	
2003	Ligji Nr. 9049, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"
2005	Ligji Nr. 9367 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"
2006	Ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800 datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855 datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170 datë 22.10.2009, Ligjin Nr. 10309 datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012 dhe Ligjin Nr. 182/2014 "Për Prokurimin Publik";
2008	Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012 datë 26.04.2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
2012	Ligji Nr. 90/2012 "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Administratës Shtetërore"
2015	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020

3. Kuadri aktual mbi etikën në Shqipëri

3.1. Kodet e etikës të miratuara me ligj

Ky seksion analizon qasjen e kodeve të etikës në përputhje me kuadrin teorik përshkruar më lart. Fillimisht janë analizuar kodet e etikës të miratuara me ligj dhe në pjesën e dytë të këtij seksioni janë analizuar kodet e etikës institucionale ose profesionale.

Siç do të përshkruhet më poshtë, në Shqipëri nuk mund të bëhet një dallim mbi mënyrën se si janë formësuar rregullat mbi etikën. Shqipëria mund të konsiderohet një vend, i cili i ka shprehur kërkesat etike në formën e rregullave, duke adoptuar kuadrin rregullator dhe një sërë kodesh etike. Pavarësisht faktit që fusha e zbatimit të Ligjit mbi Etikën i miratuar në vitin 2003 përfshin të gjithë nëpunësit civilë, një numër i konsiderueshëm kodesh etike profesionale janë miratuar në vitet në vijim. Si pasojë e boshllëkut të mëparshëm në legjisllacionin mbi etikën dhe aplikimit të qasjes e cila bazohet në rregulla duke synuar të institucionalizojë në mënyrë ligjore etikën, rezulton që Shqipëria të ketë aplikuar qasjen e cila bazohet në pajtueshmërinë me menaxhimin e etikës, duke u fokusuar në këtë mënyrë në adoptimin e procedurave administrative dhe rregullave të detajuara dhe përcaktimit të udhëzimeve dhe parimeve të përgjithshme, të cilat duhen zbatuar nga nëpunësit publikë.

Kodi i Etikës së Policisë është kodi i parë i etikës në Shqipëri miratuar me ligj, me qëllimin për të luftuar korrupsionin dhe forcuar integritetin në polici. Kodi i Etikës përcakton detyrimin e punonjësve të policisë që të “luftojnë me vendosmëri korrupsionin” dhe të denoncojnë “çdo akt të shfaqjes së korrupsionit dhe abuzimeve”.²⁹ Një tjetër formë e shkeljes ligjore e parashikuar në Kodin e Etikës

²⁹ Ligji Nr. 8291, datë 25.2.1998, Kodi i Etikës së Policisë, Neni 5

është detyrimi për të përdorur forcën në përputhje me dispozitat ligjore.³⁰ Kodi i Etikës parashikon “detyrimin [e punonjësve të policisë] për të luftuar abuzimin në kryerjen e detyrave shtetërore”.³¹ Një tjetër formë e shkeljes ligjore parashikuar në Kodin e Etikës është detyrimi për ruajtjen e sekretit”.³² Një nga mangësitë themelore të kuadrit ligjor dhe nënligjor është se nuk ofron një përkufizim të qartë mbi korrupsionin policor dhe ndarjen ndërmjet keqsjelljes dhe korrupsionit.

Në vitin 2003 u miratua Ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i cili u hartua duke u bazuar në Kodin Model të Këshillit të Evropës.³³ Qëllimi kryesor i Ligjit mbi Etikën është që të vendosë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike,³⁴ sipas standardeve të kërkuara, t’i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vërë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike.³⁵ Dispozitat e Ligjit “Për rregullat e etikës në administratën publike” (2003), janë të detyrueshme për të gjithë nëpunësit e administratës publike, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në dispozita të tjera ligjore³⁶ dhe përbëjnë gjithashtu detyrim edhe për personat e punësuar nga organizatat private që kryejnë shërbime publike.³⁷ Në këtë mënyrë zbatimi i Ligjit mbi Etikën është i detyrueshëm për të gjithë personat e punësuar në administratën publike dhe jo i kufizuar vetëm për punonjësit ose nëpunësit civilë.

Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk specifikon se cilat janë organet e administratës publike, nëpunësit publikë përmenden në Kushtetutë në nenin 107 të saj. Ndërkohë sipas Ligjit të ri Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 3/6 përcakton si “organ publik” *“çdo organ të pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative;”*³⁸ *çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislati i drejtë e ushtrimi të funksioneve administrative publike”.*

30 Ligji Nr. 8291, datë 25.2.1998, Kodi i Etikës së Policisë, Neni 10

31 Po aty. Neni 5

32 Po aty. Neni 11

33 Raporti Vjetor i DAP (2002), <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20dap/raportivjetor2002.pdf>

34 Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Neni 2/4; “Punonjës të Administratës Publike” janë të gjithë personat e punësuar në një institucion të administratës publike”

35 Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Neni 1

36 Po aty. Neni 2/1

37 Po aty. Neni 2/3

38 Kuptimi i entit publik jepet në Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”

Për pasojë, për sa kohë institucionet respektive ushtrojnë funksione administrative, fusha e zbatimit të Ligjit “Për rregullat e etikës në administratën publike” zgjerohet për të gjitha këto institucione, por nuk përbën detyrim për të zgjedhurit, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe gjyqtarët.³⁹

Ligji mbi Etikën nuk jep sqarime ose përcaktime në lidhje me terma të caktuara mbi etikën apo sjelljen etike. Ai përcakton parimet të cilat nëpunësit e administratës publike duhet të respektojnë, duke përfshirë: përputhjen me legjislacionin në fuqi, pavarësinë politike, ndershmërinë, paanshmërinë, efikasitetin, mirësjelljen, shërbimin ndaj interesave të publikut, shmangien e konfliktit të interesave, respektin për të drejtat dhe detyrat personale, besueshmërinë.⁴⁰ Ligji është hartuar në frymën urdhërore dhe ka si qëllim të rregullojë aktivitetin (“nëpunësi publik duhet të respektojë parimet si më poshtë”).⁴¹ Ndërmjet parimeve të lartpërmendura, Ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike” përshkruan në kapituj të veçantë, çështjen e konfliktit të interesave,⁴² veprimtaritë e jashtme të nëpunësve të administratës publike dhe përfitimin (dhuratat dhe favoret).⁴³

Ligji mbi Etikën e përkufizon konfliktin e interesit si “situata në të cilën një nëpunës i administratës publike ka një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare”.⁴⁴ Interesat private përkufizohen si “çdo përparësi për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilët nëpunësi ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose lidhje politike, gjithashtu çdo lloj detyrimi financiar ose civil të nëpunësit”.⁴⁵ Ligji parashikon mjetet për shmangien e konfliktit të interesit të cilat përfshijnë: zgjidhjen e çdo konflikti interesi përpara punësimit, si dhe detyrimin për të zgjidhur konfliktin e interesit në çdo shkallë kur zyrtari dyshon që një konflikt i tillë është shfaqur. Zyrtari e zgjidh konfliktin e interesit duke njoftuar eprorin direkt ose njësinë e personelit. Të dyja instancat kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur konfliktin e interesave të zyrtarit. Ligji parashikon zgjidhjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit duke detyruar zyrtarin të heqë dorë ose të transferojë këto të drejta.⁴⁶

39 Ligji Nr. 9131, date 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Neni 2/2

40 Po aty.

41 Po aty. Neni 3/1

42 Konflikti i Interesave rregullohet më tej me Ligjin Nr. 9367, date 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Neni 13; 30-32

43 Ligji Nr. 9131, date 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Kapitujt II, III, IV

44 Po aty. Neni 4/1

45 Po aty. Neni 4/2

46 Po aty. Neni 5

Ligji rregullon veprimtarinë e jashtme të zyrtarit publik. Kjo veprimtari përcaktohet si “çdo lloj veprimtarie e rregullt apo e rastësishme që kërkon angazhimin e nëpunësit të administratës publike, qoftë për qëllime fitimi ose jo, që nëpunësi zhvillon jashtë detyrës së tij zyrtare.”⁴⁷ Ligji nuk ndalon kryerjen e veprimtarive të jashtme nga nëpunësi publik kur këto veprimtari nuk e pengojnë nëpunësin në kryerjen e detyrës së tij zyrtare, nuk dëmtojnë imazhin e nëpunësit ose institucionit dhe me njoftim paraprak të eprorit të drejtpërdrejtë.⁴⁸

Për më tepër, ligji ndalon nëpunësin publik të kërkojë ose të pranojë, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër për veten, familjen, të afërmit, personat apo organizatat me të cilat ka marrëdhënie. Ligji i kërkon nëpunësit të refuzojë çdo përfitim të tillë dhe të raportojë çdo përpjekje për dhënien e një përfitimi të tillë.⁴⁹ Rregullimi i veprimtarive të jashtme dhe përfitimeve rregullohet më tej me vendime të Këshillit të Ministrave.⁵⁰

Ligji parashikon detyrimet gjatë punësimit në administratën publike në lidhje me kohën e punës dhe burimet si dhe detyrimet e tij për periudhën pas punësimit përsa i përket përdorimit të informacionit konfidencial dhe ndalimit të përfaqësimit të asnjë personi ose organizate në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike.⁵¹

Ligji “Për rregullat e etikës në administratën publike” përcakton që dispozitat e këtij ligji janë pjesë e kushteve të punësimit të nëpunësit dhe shkelja e këtyre dispozitave mund të bëhet shkak për marrjen e masave disiplinore.⁵² Për sa i përket sanksioneve, ligji parashikon zbatimin e masave disiplinore në përputhje me Ligjin “Për Statusin e Nëpunësit Civil” dhe i kërkon institucioneve publike dhe Departamentit të Administratës Publike (DAP) të regjistrojë të gjitha masat disiplinore në Regjistrin Kombëtar të Administratës Publike.⁵³

3.2. Kodet e etikës institucionale ose profesionale

Pas mesit të viteve 2000 në Shqipëri u miratuan një numër kodesh etike me qëllimin për të udhëhequr sjelljen profesionale (deontologjike) dhe personale të

47 Ligji Nr. 9131, date 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Neni 6

48 Po aty. Nenet 7-8

49 Po aty. Neni 11

50 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 714, datë 22.10.2004, “Për Veprimtarinë e Jashtme dhe Dhënien e Dhuratave së Nëpunësit të Administratës Publike”

51 Ligji Nr. 9131, date 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Nenet 12-17

52 Po aty. Nenet 18/4

53 Po aty. Nenet 19-20

punonjësve në institucionet përkatëse.

Ky seksion analizon kodet e etikës të miratuara në Shqipëri, me qëllim vlerësimin e fushës së veprimtarisë dhe rëndësinë e tij. Bazuar në këtë analizë, siç dhe mund të evidentohet më poshtë, mund të arrihet në përfundimin se pjesa më e madhe e kodeve të etikës, sidomos kodet institucionale, përfshijnë të njëjtat parime të përgjithshme siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Etikën në Administratën Publike (2003). Një përjashtim i veçantë është evidentuar gjatë analizës së kodeve të etikës të miratuara në sektorin e shëndetësisë, të cilat përveç miratimit të parimeve të përgjithshme të etikës sipër përmendur, kanë për qëllim të rregullojnë çështjet specifike të deontologjisë mjekësore dhe qëllimi i tyre kryesor është të krijojnë udhëzimet e praktikës profesionale dhe marrëdhëniet me palët e tjera.

Duke vlerësuar qasjen e përgjithshme sipas së cilës këto kode etike janë miratuar, mund të kuptohet që ekziston një kufizim në lidhje me një kuptueshmëri të qartë të qëllimit ose objektivave të tyre, si është p.sh. rasti i kodeve të etikës miratuar nga tre Bashki, bazuar në nismën e kryebashkiakëve.⁵⁴

Një nga kodet e para të etikës miratuar pas vitit 2000 është **Kodi i Etikës i Bankës së Shqipërisë (BSH)**. Kodi u miratua në vitin 2003 dhe përbëhet nga 4 pjesë kryesore. Pjesa e parë përfshin një përkufizim se çfarë do të kuptohet me “etikë” dhe “sjellje etike” në Bankën e Shqipërisë.⁵⁵ Pjesa e dytë (Konsiderata të përgjithshme) përshkruan qëllimin e kodit, shtrirjen dhe objektivat e Bankës së Shqipërisë dhe mekanizmat e sanksioneve për zbatimin e kodit.⁵⁶ Pjesa e tretë e kodit rregullon rregullat etike për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Kjo pjesë përfshin standardet bazë të sjelljes,⁵⁷ përdorimin dhe përhapjen e informacionit,⁵⁸ konfliktet e interesave dhe çështje të tjera.⁵⁹ Në pjesën e fundit të kodit përshkruhen rregullat e etikës për anëtarët e stafit të bankës, duke përfshirë standardet bazë të sjelljes,⁶⁰ sjelljen brenda Bankës së Shqipërisë,⁶¹ përdorimin dhe përhapjen e informacionit,⁶² konfliktet e interesave,⁶³ aktivitetet e jashtme dhe çështje të

54 Bashkia Bilisht, Shkodër dhe Korçë. Shiko: <http://bashkiabilisht.com/kodi-etik-i-bashkise-bilisht.html>; <http://www.korcaregion.com/index.php?lang=1&idm=147&idr=52&mod=1>; file:///C:/Documents%20and%20Settings/Mirsada/My%20Documents/Downloads/kodi_etik.pdf

55 Kodi i Etikës i Bankës së Shqipërisë, faqe 5

56 Po aty, faqe 7

57 Po aty. Pjesa 3, Kapitulli I

58 Po aty, Pjesa 3, Kapitulli II

59 Po aty. Pjesa 3, Kapitulli III

60 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli I

61 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli II

62 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli III

63 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli IV

tjera.⁶⁴ Lidhur me mekanizmin e sanksioneve, kodi i referohet dispozitave të ligjit për Bankën e Shqipërisë.

Kodi i Etikës së Avokatit i miratuar në vitin 2005 synon të trajtojë vendosjen, respektimin dhe zbatimin e rregullave të sjelljes, të etikës profesionale të avokatit në shërbim të mbrojtjes të të drejtave dhe interesave legjitime të klientit dhe në shërbim të interesave të drejtësisë.⁶⁵ Në kapitullin e parë ky kod përcakton parimet e përgjithshme që duhen respektuar në ushtrimin e profesionit të avokatit të tilla si pavarësia, dinjiteti i profesionit, përkushtimi dhe aftësitë, veprimtaritë dhe punësimet e papajtueshme, konfidencialitetin.⁶⁶ Marrëdhëniet me klientë janë përshkruar në një kapitull të veçantë (Kreu II) dhe parashikojnë detyrimin e avokatit për të respektuar interesat e klientit, detyrën për të informuar klientin dhe përdorimin me miratimin e klientit të pasurisë dhe fondeve të tij.⁶⁷ Kodi parashikon gjithashtu edhe rregullimin e konfliktit të interesave, ndërprerjen e përfaqësimit dhe të mbrojtjes dhe tërheqjen e përfaqësimit.⁶⁸ Marrëdhëniet me gjykatën janë përshkruar në kapitullin III të kodit.⁶⁹ Kodi rregullon edhe marrëdhëniet ndërmjet avokatëve dhe marrëdhëniet me publikun.⁷⁰ Në nenin 54 të kodit janë parashikuar mekanizmat e sanksioneve në rastet e shkeljeve etike, të cilat janë të bazuara në dispozitat e ligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) u miratua në vitin 2005. Kodi përbëhet nga 6 kapituj dhe jep një përkufizim se çfarë do të kuptohet me “etikë” dhe “sjellje etike” në Kontrollin e Lartë të Shtetit.⁷¹ Kodi përshkruan qëllimin e tij, shtrirjen dhe objektivat e KLSH,⁷² misionin e institucionit,⁷³ parimet që udhëheqin institucionin⁷⁴ dhe vlerat bazë të institucionit.⁷⁵ Në një kapitull më vete në kod janë përshkruar rregullat e etikës në KLSH.⁷⁶ Ndërkohë kodi rregullon çështje që lidhen me konfliktin e interesave dhe detyrimin për të deklaruar informacione,⁷⁷

64 Kodi i Etikës i Bankë së Shqipërisë, Pjesa 4, Kapitulli V

65 Kodi i Etikës i Avokatit, faqe 1

66 Po aty. Nenet 1-14

67 Po aty. Nenet 15-18

68 Po aty. Nenet 21-29

69 Po aty. Nenet 30-34

70 Po aty. Nenet 35-53

71 Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kapitulli I, Neni 1

72 Po aty. Neni 2

73 Po aty. Kapitulli I, Neni 4

74 Po aty. Neni 5

75 Po aty. Neni 6

76 Po aty. Kapitulli II, Nenet 7-21

77 Po aty. Kapitulli III, Nenet 20, 21

përdorimin dhe përhapjen e informacionit⁷⁸ dhe aktivitetet e jashtme dhe çështje të tjera.⁷⁹ Kodi etik në nenin 29 parashikon mekanizmat e sanksioneve në rastin e shkeljeve etike në përputhje me legjislacionin e Kodit të Punës ose Ligjit “Për Nëpunësin Civil”, sipas rastit.

Në vitin 2008 u miratuan kodet e etikës në sektorin e shëndetësisë, të cilat kanë si qëllim të rregullojnë rregullat e etikës në profesione specifike në sektorin e shëndetësisë, si p.sh., profesionet e përfshira në Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë, farmacistët, mjekët, dentistët dhe psikologët të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre profesionale në Republikën e Shqipërisë.

Kodi Etik-Deontologjik për profesionet e Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë u miratua në vitin 2008, një vit pas miratimit të Urdhrit të infermierit në Republikën e Shqipërisë.⁸⁰ Kodi jep një përshkrim mbi përmbajtjen e tij (vlerat dhe parimet) dhe bazën e tij ligjore.⁸¹ Në nenin 1 Kodi jep një përshkrim të detajuar në lidhje me profesionet e Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 2 janë përshkruar detyrimet e etikës profesionale dhe në nenin 3 trajnimi i vazhdueshëm profesional për profesionet e Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë. Kodi rregullon në nenin 4 marrëdhëniet ndërmjet profesioneve të Urdhrit të infermierit në Republikën e Shqipërisë me pacientët dhe e detajon këtë marrëdhënie në Nenin 5 (pakti mes infermierit dhe pacientit). Ndërkohë kodi rregullon edhe marrëdhënie të tjera, të tilla si ato me kolegët dhe operatorët të tjerë (neni 6) dhe marrëdhëniet me institucionet (neni 7). Neni 8 përshkruan rregulloren e gjykimit profesional dhe në nenin 9 rregullohen masat disiplinore në rast të shkeljeve të etikës dhe mënyra se si do të trajtohen këto masa.⁸²

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Farmaceutike përbëhet nga pesë kapituj. Kapitulli i parë trajton parimet kryesore në deontologjisë farmaceutike duke përfshirë: përkufizimin në çfarë deontologjia farmaceutike është.⁸³ Kapitulli II rregullon detyrimet e farmacistit ndaj pacientit⁸⁴ dhe kapitulli III marrëdhëniet mes kolegëve dhe punonjësve të tjerë në sektorin e shëndetësisë.⁸⁵ Në kreun IV parashikohen kushtet e ushtrimit të profesionit. Në kapitullin e fundit janë përshkruar dispozita

78 Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kapitulli IV, Nenin 22,23

79 Po aty. Kapitulli V, Nenin 24-28

80 Ligji Nr. 9718, datë 19.04.2007 “Urdhri i Infermierit në Republikën e Shqipërisë”

81 Kodi Etik-Deontologjik për Profesionet e “Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, Dispozita të Përgjithshme

82 Kodi Etik-Deontologjik për Profesionet e “Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë”, Neni 10

83 Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Farmaceutike, Kapitulli I, Nenin 1-12

84 Po aty. Kapitulli II, Nenin 13-21

85 Po aty. Kapitulli III, Nenin 22-28

përfundimtare në lidhje me zbatimin e kodit dhe mekanizmi i sanksioneve.⁸⁶

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore jep një përkufizim mbi disa parime kryesore të tilla si deontologjia mjekësore, njohja e legjislacionit, Urdhrit të Mjekëve në Republikën e Shqipërisë dhe kodit të etikës.⁸⁷ Në kapitullin e parë ky kod përshkruan detyrat e përgjithshme të mjekëve.⁸⁸ Në kapitullin e dytë kodi rregullon detyrimet e mjekut ndaj pacientit.⁸⁹ Në kapitullin III parashikohen marrëdhëniet midis kolegëve, ndaj profesionit dhe institucioneve⁹⁰ dhe në kapitullin IV rregullohet qëndrimi i mjekut ndaj riprodhimit human, eksperimenteve klinike dhe kërkimeve bio-mjekësore dhe transplantimeve të indeve e organeve.⁹¹ Në kapitullin V rregullohen kushtet për ushtrimin e profesionit.⁹² Kapitulli i fundit përcakton dispozitat përkatëse në lidhje me zbatimin e kodit dhe mekanizmat e sanksioneve.⁹³

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve përbëhet nga III pjesë kryesore. Kodi jep një përshkrim në lidhje me përmbajtjen e tij dhe parimet e përgjithshme. Pjesa e parë rregullon çështjet që lidhen me ushtrimin e profesionit, duke përfshirë edhe përkufizimin e tij,⁹⁴ kushtet e ushtrimit të profesionit,⁹⁵ modalitetet teknike për ushtrimin e profesionit,⁹⁶ detyrimet e psikologut ndaj kolegëve⁹⁷ dhe rolin e psikologut në psikologji.⁹⁸ Pjesa II e kodit përshkruan formimin e psikologut⁹⁹ dhe pjesa III përshkruan dispozitat si lidhje me punën kërkimore në psikologji.¹⁰⁰ Kodi nuk parashikon ndonjë mekanizëm të sanksioneve në rastet e shkeljes së kodit.

Ndërkohë në vitin 2014 u miratua Ligji Nr. 127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë”, i cili në nenet 1/5-ç; 5/4-c; 6/2-a; 11/2-e; 14/3; 15/1 adreson njohjen mbi Kodin Etik Deontologjik Stomatologjik.

Në sektorin e shëndetësisë është analizuar gjithashtu *Kodi i Etikës i Spitalit Rajonal*

86 Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Farmaceutike, Kapitulli V, Nenet 38-40

87 Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Nenet 1-3

88 Po aty. Kapitulli I, Nenet 4-17

89 Po aty. Kapitulli II, Nenet 18-41

90 Po aty. Kapitulli III, Nenet 42-48

91 Po aty. Kapitulli IV, Nenet 49-57

92 Po aty. Kapitulli V, Nenet 49-57

93 Po aty. Kapitulli VI, Nenet 66-69

94 Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve, Pjesa I, Kapitulli I, Nenet 1-3

95 Po aty. Pjesa I, Kapitulli II, Nenet 4-22

96 Po aty. Pjesa I, Kapitulli III, Nenet 23-28

97 Po aty. Pjesa I, Kapitulli IV, Nenet 29-31

98 Po aty. Pjesa I, Kapitulli V, Nenet 32-33

99 Po aty. Pjesa II, Nenet 34-43

100 Po aty. Pjesa III, Nenet 44-55

Durrës.¹⁰¹ Kodi u miratua në vitin 2014 dhe përbëhet nga 4 pjesë kryesore. Pjesa e parë përfshin një përkufizim se çfarë do të kuptohet me “etikë” dhe “sjellje etike” në Spitalin Rajonal të Durrësit.¹⁰² Pjesa e dytë (Konsiderata të përgjithshme) përshkruan qëllimin e kodit, shtrirjen dhe objektivat e Spitalit Rajonal Durrës dhe mekanizmat e sanksioneve për zbatimin e kodit.¹⁰³ Pjesa e tretë e kodit rregullon rregullat etike për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Kjo pjesë përfshin standardet bazë të sjelljes, përdorimin dhe përhapjen e informacionit,¹⁰⁴ konfliktet e interesave dhe çështje të tjera.¹⁰⁵ Në pjesën e fundit të kodit përshkruhen rregullat e etikës për anëtarët e stafit të spitalit, duke përfshirë standardet bazë të sjelljes,¹⁰⁶ sjelljen brenda Spitalit Rajonal Durrës,¹⁰⁷ përdorimin dhe përhapjen e informacionit,¹⁰⁸ konfliktet e interesave,¹⁰⁹ aktivitetet e jashtme dhe çështje të tjera.¹¹⁰ Në kapitullin V të kodit është parashikuar funksionimi i Strukturës Mbikëqyrëse e Etikës, e cila përbëhet nga 3 anëtarë. Shkelja e rregullave të Kodit, Ligjit “Për Nëpunësin Civil”, Kodit të Punës, Rregullores së Brendshme, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës u miratua në vitin 2007. Kodi parashikon në nenet 1 dhe 2 qëllimin e tij dhe fushën e zbatimit. Në nenin 3 janë përshkruar dispozitat dhe parimet e përgjithshme, duke përfshirë:¹¹¹ ndalimin e diskriminimit, paanësisë, konfliktit të interesit, dhuratave apo favore të tjera, mbrojtjen e personalitetit të nëpunësit, përdorimin e informacionit, marrëdhëniet me median, aktivitete të tjera, sjelljen në jetën shoqërore dhe mbrojtjen e asetëve të institucionit.¹¹² Në nenin 15 përshkruhen sanksionet dhe detyrimi për informacion. Çdo zyrtar i institucionit është i obliguar që të njohë dhe të zbatojnë kodin. Sa i përket shkeljeve të kodit zbatohen sanksione në përputhje me Ligjin Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodit të Punës dhe Ligjit “Për Nëpunësin Civil”.¹¹³ Çdo shkelje e kodit duhet të adresohet tek Komisioni apo

101 Kodi i Etikës i Spitalit Rajonal Durrës, faqe 4

102 Po aty. faqe 5

103 Po aty. Pjesa 3, Kapitulli I

104 Po aty. Pjesa 3, Kapitulli II

105 Po aty. Pjesa 3, Kapitulli III

106 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli I

107 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli II

108 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli III

109 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli IV

110 Po aty. Pjesa 4, Kapitulli V

111 Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës, Neni 4

112 Po aty. Nenet 5-14

113 Po aty. Neni 15/15.1

Sekretari i Përgjithshëm.¹¹⁴

Kodet e etikës në sektorin e arsimit kanë për qëllim të rregullojnë sjelljet etike të stafit akademik dhe të studentëve sipas standardeve të etikës profesionale. Në vitin 2011 Universiteti i Tiranës ka miratuar kodin e tij të etikës dhe pas tij institucione të tjera në sektorin e arsimit kanë miratuar kodet e tyre të etikës.

Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës rregullon çështje të etikës në lidhje me detyrimet e punonjësve,¹¹⁵ detyrimet e studentëve,¹¹⁶ përhapjen e dijeve dhe lirinë akademike.¹¹⁷ Në rast të shkeljes së dispozitave të etikës siç është përshkruar në nenet 4 dhe 5, kodi parashikon mekanizma të sanksioneve,¹¹⁸ të cilat mund të raportohet në bazë të nenit 9 të kodit. Mekanizmat e sanksioneve janë të ndara në disa kategori në bazë të llojit të dispozitës së shkelur.¹¹⁹ Në Nenin 8 të kodit është paraparë Këshilli i Etikës, një strukturë mbikëqyrës e cili krijohet dhe funksionon si një organ disiplinor në rast të shkeljeve të etikës. Këshilli i Etikës funksionon në bazë të dispozitës së nenit 10 të kodit.

Kodi i Etikës i Universitetit Politeknik të Tiranës rregullon të njëjtat çështje të etikës të përmendura më lart siç parashikohen në kodin e etikës të Universitetit të Tiranës, por në të njëjtën kohë rregullon edhe çështjet tw tjera të etikës si p.sh., sjelljet e ndaluara,¹²⁰ pronësisë intelektuale¹²¹ dhe plagjiatura akademike.¹²² Kodi përshkruan në nenin 4 parimet e përgjithshme. Artikulli 11 përcakton organin përgjegjës për të mbikëqyrur zbatimin e kodit të etikës, i quajtur Këshilli i Etikës, një strukturë e ngjashme siç parashikohet në kodin e etikës të Universitetit të Tiranës. Procedurat që do të trajtohen në rast të shkeljeve të etikës dhe masave disiplinore janë parashikuar në nenet 12 dhe 13 të kodit.

Kodi i Etikës i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, përveç çështjeve të etikës në sektorin e arsimit përmendur më lart, të rregullon edhe disa çështje të tjera. Kodi rregullon politikat anti-diskriminuese,¹²³ konfidencialitetin e informacionit,¹²⁴

114 Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës, Neni 15/15.2

115 Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës, Neni 4

116 Po aty. Neni 5

117 Po aty. Neni 6

118 Po aty. Neni 7

119 Po aty. Neni 7, a./b./c. dhe d.

120 Kodi i Etikës i Universitetit Politeknik të Tiranës, Neni 8

121 Po aty. Neni 9

122 Po aty. Neni 10

123 Kodi i Etikës i Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Neni 6

124 Po aty. Neni 7

përdorimin e “emrit” të Universitetit,¹²⁵ burimet e Universitetit,¹²⁶ gacmimet seksuale,¹²⁷ marrëdhëniet personale,¹²⁸ konfliktin e angazhimit,¹²⁹ shërbime administrative,¹³⁰ format e komunikimit me shkrim,¹³¹ komunikimin elektronik,¹³² etikën dhe mënyrën e të shkruarit.¹³³ Në kapitullin VI kodi parashikon masa disiplinore.¹³⁴ Në nenin 24 kodi jep një përshkrim në lidhje me mënyrën se si duhet të trajtohen shkeljet e etikës. Masat disiplinore klasifikohen në varësi të shkeljes së dispozitave siç parashikohet në kod¹³⁵ dhe në nenin 26 të kodit parashihet Këshilli i Etikës, një strukturë mbikëqyrëse e cili është krijuar dhe funksionon si një organ disiplinor në rast të shkeljeve etike.

Kodi i Etikës i Universitetit “Ismail Qemali” në Vlorë u miratua në vitin 2008 bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë”, neni 17. Ai përcakton në Kapitullin I qëllimin e tij, misionin, parimet dhe vlerat, zbatimin dhe monitorimin e kodit. Në Kreun II jepen përkufizime në lidhje me kodin e etikës, mënyrën se si kodi duhet të komunikohet dhe përbërjen e Këshillit të Etikës. Në Kapitullin III rregullohen detyrimet dhe sjelljet e ndaluara dhe në Kapitullin IV janë parashikuar procedura për të trajtuar shkeljet e etikës. Kapitulli V përshkruan llojin e masave disiplinore.

Kodi i Etikës i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit ndryshe nga dispozitat e kodeve të etikës të përmendura më lart, përshkruan udhëzime se si studentët dhe stafi duhet të sillen në mënyrë etike, si duhet të shmangin aktet e paligjshme dhe të papërshtatshme, si profesorët duhet të respektojnë studentët dhe në fund kodi përshkruan sjelljet të cilat mund të bëhen subjekt i masave disiplinore. Kodi nuk parashikon ndonjë organ disiplinor përgjegjës për kryerjen e këtyre masave.

Përveç kodeve të etikës të analizuar më sipër, në sektorin e arsimit në vitin 2012 është miratuar *Kodi i Etikës së Mësuesit në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat*, i cili përcakton parimet themelore, qëllimin e kodit dhe fushat e veprimit të cilat ndahen në dy pjesë kryesore. Fusha e parë është e fokusuar në përkushtimin ndaj nxënësit dhe procesit të të nxënës dhe fusha e dytë është e fokusuar në

125 Kodi i Etikës i Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Neni 8

126 Po aty. Neni 9

127 Po aty. Neni 10

128 Po aty. Neni 11

129 Po aty. Neni 12

130 Po aty. Neni 14

131 Po aty. Neni 19

132 Po aty. Neni 20

133 Po aty. Neni 21

134 Po aty. Nenet 24-26

135 Po aty. Neni 25, a./b./c./d./e./f./g.

përkushtimin ndaj profesionit, një mjedisi mbështetës dhe bashkëpunues të nxëni. Kodi përfshin udhëzime për respektimin e kodit të etikës. Në rastet e shkeljeve të etikës kodi i referohet Kodit të Punës, Ligjit për arsimin parauniversitar, dispozitave normative në arsim dhe kontratave kolektive të punonjësve të arsimit. Kodi parashikon Komisionin e Etikës dhe të Sjelljes në përputhje me nenin 33 të Ligjit për arsimin parauniversitar.

Në vitin 2014 u miratuan një numër kodesh etike. **Kodi i Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar** u miratua në vitin 2014. Kodi jep një përkufizim për rregullat e etikës dhe përshkruan qëllimin dhe përmbajtjen e tij. Kodi ka për qëllim të rregullojë 12 elementet e etikës, të cilat janë të detajuara më tej në kod, duke përfshirë: përgjegjësinë personale; respektimin e ligjit; marrëdhëniet me publikun; vënien e kufijve në pranimin e dhuratave, shpërblimeve si dhe ftesave të ndryshme; shmangien e konfliktit të interesave; aktivitetet me karakter publik; vënien e kufijve për veprimtaritë politike; sjelljet që përfshijnë çështje monetare; përdorimin e informacioneve konfidenciale/sekretit profesional; përdorimin e pronave dhe shërbimeve shtetërore; blerjen për qëllime private të objekteve që i përkasin shtetit nga ana e punonjësve dhe ambientit të punës. Sa i përket masave disiplinore, kodi i etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar është bazuar në masat siç parashikohet në Ligjin “Për Nëpunësin Civil”.

Kodi i Etikës i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave u miratua në vitin 2014 dhe ka për qëllim të rregullojë normat e sjelljes të nëpunësve të institucionit.¹³⁶ Kodi përcakton parimet e përgjithshme etike,¹³⁷ konfliktin e interesit, veprimtaritë e jashtme, dhuratat dhe favorët, detyrimet e nëpunësve të AKKP.¹³⁸ Parimet e kodit të AKKP duhet të njihen nga nëpunësit e AKKP çdo fillim vit ose në fillim të marrëdhënieve të punës duke plotësuar një deklaratë.¹³⁹ Në Kod është parashikuar mekanizmi i sanksioneve, të cilat bazohen në dispozitat e Kodit të Punës dhe në Rregulloren e Brendshme të AKKP.¹⁴⁰

Kodi i Etikës i Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) u miratua në vitin 2014 dhe është e ndarë në 3 kapituj. Kapitulli i parë rregullon dispozitat e përgjithshme mbi etikën, duke përfshirë, pavarësinë dhe paanësinë; konfliktin e interesave; ushtrimin e veprimtarive të jashtme; profesionalizmin; konfidencialitetin; integritetin dhe korrektësinë.¹⁴¹ Në kapitullin e dytë janë rregulluar marrëdhëniet institucionale dhe

¹³⁶ Për Kodin e Etikës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Neni 1

¹³⁷ Po aty. Neni 2

¹³⁸ Po aty. Nenet 3-14

¹³⁹ Po aty. Neni 15

¹⁴⁰ Po aty. Neni 17

¹⁴¹ Kodi i Etikës i ILDKPKI, Nenet 1-9

ndërinstitucionale¹⁴² dhe në kapitullin e fundit të kodit është parashikuar struktura mbikëqyrëse e kodit të etikës.¹⁴³ Mekanizmat e sanksioneve janë të bazuara në Ligjin “Për Nëpunësit Civil”, Kodin e Punës dhe Rregulloren e Brendshme.¹⁴⁴

Kodi i Etikës për Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë përcakton qëllimin dhe fushën e tij të veprimit,¹⁴⁵ parimet e përgjithshme,¹⁴⁶ aktivitetet jashtë objektit të veprimtarisë së punës.¹⁴⁷ Për zbatimin e kodit janë marrë në konsideratë procedurat siç parashikohet në rregulloren e brendshme dhe aktet ligjore në fuqi duke përcaktuar në këtë mënyrë masat përkatëse disiplinore.

Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative të Avokatit të Popullit parashikon në Kapitullin I (Dispozita të Përgjithshme) qëllimin e kodit, përkufizime, fushën e zbatimit personal dhe material, etikën dhe sjelljen etike. Në Kreun II përshkruhen parimet e përgjithshme të sjelljes etike. Kodi rregullon edhe normat e etikës që duhet të zbatohen gjatë procesit të pritjes, shqyrtimit, verifikimit dhe zgjidhjes së ankesave/kërkesave apo njoftimeve.¹⁴⁸ Po ashtu, Kodi rregullon informimin dhe aksesin në dokumentacion,¹⁴⁹ rregullat dhe shkeljet e veçanta¹⁵⁰ dhe mekanizmat e sanksioneve.¹⁵¹ Sa i përket shkeljeve të rregullave të etikës kodi bazohet në masat disiplinore të parashikuara në Ligjin “Për Nëpunësin Civil”, Rregulloren e Brendshme ose në Kontratën e Punës.

Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm u miratua në vitin 2011 dhe ka për qëllim të promovojë një kulturë etike në ushtrimin e auditivit të brendshëm. Kodi është i përbërë nga dy pjesë: pjesa e parë rregullon parimet që kanë të bëjnë me profesionin dhe ushtrimin e aktivitetit të auditivit të brendshëm, duke përfshirë: integritetin; objektivitetin dhe paanshmërinë; konfidencialitetin dhe kompetencën. Pjesa e dytë rregullon rregullat e sjelljes, të cilat përcaktojnë normat e sjelljes që duhet të zbatohet audituesi i brendshëm.

Kodi i Integritetit i Entit Rregullator i Ujit të Shqipërisë (ERRU) është miratuar në vitin 2012. Në nenet 1 dhe 2 kodi përkufizon qëllimin dhe fushën e tij të veprimit.

142 Kodi i Etikës i ILDKPKI, Nenet 10-12

143 Po aty. Neni 13

144 Po aty. Neni 14

145 Kodi i Etikës për Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, Kapitulli II

146 Po aty. Kapitulli III

147 Po aty. Kapitulli IV

148 Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative të Avokatit të Popullit, Kapitulli III, Nenet 14-20

149 Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative të Avokatit të Popullit, Nenet 21-24

150 Po aty. Nenet 25-38

151 Po aty. Neni 37

Kodi parashikon organet përgjegjëse për zbatimin e kodit¹⁵² dhe Komitetin e Integritetit. Kodi rregullon gjithashtu edhe parimet e përgjithshme,¹⁵³ përfshirë paanshmërinë; konfliktin e interesit; dhuratat dhe favoret, informacionin dhe konfidencialitetin dhe marrëdhëniet me jashtme.¹⁵⁴

Kodi i Etikës dhe Parimet Bazë të Punës së Vëzhguesit Vendor i miratuar në vitin 2011 shërben si një udhëzues për vëzhguesit vendorë të zgjedhjeve. Kodi jep përkufizime për terma të tilla si “vëzhgim i procesit zgjedhor”, “vëzhgues” dhe parashikon parimet bazë të etikës dhe profesionale mbi të cilat duhet të mbështetet puna e një vëzhguesi duke përfshirë: objektivitetin, pavarësinë, kompetencën, profesionalizmin/besueshmërinë e gjykimit, transparencën dhe saktësinë. Në kod nuk janë parashikuar mekanizma sanksionesh sa i përket shkeljeve të rregullave etike.

Kodi i Etikës për Administratorët e Falimentit jep një përkufizim mbi Kodin e Etikës në preambulën e tij dhe përcakton fushën e zbatimit dhe qëllimin. Kodi është i ndarë në 3 kapituj. Në kapitullin e parë janë përshtuar parimet kryesore që udhëheqin kodin përfshirë: ligjshmërinë, përgjegjësinë, integritetin, profesionalizmin, objektivitetin, pavarësinë, paanësinë, konfidencialitetin dhe konfliktin e interesit. Kapitulli II përfshin rregullat e etikës në praktikë.

152 Kodi i Integritetit i ERRU, Neni 3

153 Po aty. Neni 4

154 Po aty. Nenet 5-9

4. Zbatimi i Etikës

4.1 Kuadri institucional

4.1.1. Departamenti i Administratës Publike (DAP)

Monitorimi i Ligjit Nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, kryhet nga institucionet përmes njësive të tyre të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, konsiderohet si rregull që njësitë e institucionit për menaxhimin e burimeve njerëzore të krijohen nga çdo institucion brenda fushës së veprimit të këtij ligji.¹⁵⁵ Këshilli i Ministrave mund të vendosë që disa institucione të administratës shtetërore të krijojnë një njësi të përbashkët të menaxhimit të burimeve njerëzore apo që një pjesë e funksioneve të njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore të një institucioni të varësisë të kryhen nga institucioni epror.¹⁵⁶

Departamenti i Administratës Publike (DAP) është themeluar në vitin 1994 dhe iu referua Ligjit për Shërbimin Civil të miratuar fillimisht në vitin 1996. DAP u bë një agjenci qendrore përgjegjëse për hartimin e një politike të përgjithshme për rekrutimin, trajnimin dhe promovimin e nëpunësve civilë dhe koordinim dhe zbatimin e asistencës teknike për administratën publike. DAP funksionon si pjesë e aparatit të Ministrisë së Brendshme dhe është nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Ministrit të Brendshëm.¹⁵⁷ Detyrat kryesore dhe të drejtat e DAP janë parashikuar në Ligjin për Nëpunësin Civil.¹⁵⁸ Gjithashtu ligji parashikon që çdo institucion, që punëson nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik dhe nëpunës civil, që

¹⁵⁵ Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 10/1

¹⁵⁶ Po aty. Neni 10/2

¹⁵⁷ Po aty. Neni 7/1

¹⁵⁸ Po aty. Neni 7/2 (a-i); 7/3 (a-b)

kanë kompetenca menaxheriale vendimmarrëse ose që kanë informacione në këtë fushë, është i detyruar të bashkëpunojnë me DAP-in.¹⁵⁹ Në vitin 2014, me Urdhër të Kryeministrit Nr. 91, datë 21 Shkurt, 2014 u krijua një strukturë e re më e zgjeruar e DAP, duke përfshirë katër drejtori kryesore dhe një staf prej 43 punonjësish.¹⁶⁰

Në vijim të reformave në administratën publike, DAP ka miratuar së fundmi "Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020", e cila përbëhet nga 5 pjesë kryesore, përfshirë: (I) Kushtet aktuale (II) Vizionin, Politikat dhe Qëllimet e Politikave (III) Objektivat e Politikës dhe Produktet Madhore (IV) Llogaridhënien, Monitorimin dhe Analizën Vlerësuese dhe (V) Financimin e Strategjisë. Strategjia i kushton vëmendje fushave dhe sfidave që lidhen me: politikëbërjen dhe cilësinë e legjislacionit, organizimin dhe funksionimin e administratës publike, shërbimin civil, menaxhimin e burimeve njerëzore, procedurat administrative dhe mbikëqyrjen.¹⁶¹

Gjithashtu në kuadër të reformave në administratën publike, konsideruar si një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, DAP koordinon ndihmën teknike të dhënë nga donatorë të ndryshëm në kuadër të modernizimit të shërbimit civil dhe administratës publike në tërësi. Bazuar në informacionin e marrë në faqen zyrtare të institucionit, departamenti në mënyrë të vazhdueshme analizon progresin e bërë dhe nxjerrë në pah sipas fushave, nevojat për financime të mëtejshme. Në mbështetje të reformës në administratën publike, Departamenti i Administratës Publike gjatë viteve është asistuar në nivel teknik nga donatorë të ndryshëm, si nga fonde të Bashkimit Evropian, Banka Botërore, apo dhe donatorë të tjerë të rëndësishëm si UNDP, OSCE, GIZ, SIGMA, INWENT, SOROS, etj.¹⁶²

Në kuadër të raportimit DAP ka prezantuar në mënyrë sistematike Raporte Vjetore të cilat janë bërë publike në faqen zyrtare të internetit.¹⁶³ Gjithashtu gjatë periudhës duke filluar nga viti 2009-2012, DAP ka publikuar në faqen e internetit revistat e institucionit.¹⁶⁴

4.1.2. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), është një institucion publik qendror, me seli në Tiranë, i krijuar në vitin 2013 në varësi të Ministrit

159 Ligji Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", Neni 7/4

160 <https://www.google.al/webhp?hl=en#hl=en&q=struktura+e+re+DAP>

161 Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020, DAP

162 <http://www.dap.gov.al/dokumenta/projekte>

163 <http://www.dap.gov.al/dokumenta/raportet-vjetore>

164 <http://www.dap.gov.al/dokumenta/botimet>

të Brendshëm.¹⁶⁵ Shkolla e bazon strategjinë dhe veprimtarinë e saj në Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin Civil”. Aktiviteti i ASPA-s synon formimin profesional të nëpunësve civilë, si çdo individ tjetër vendas ose të huaj, që nuk është pjesë e shërbimit dhe plotëson kriteret e kërkuara.¹⁶⁶ ASPA organizohet dhe funksionon bazuar në VKM Nr. 220, datë 13.02.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Trajnimit të Nëpunësve të Administratës Publike”. Organet e ASPA janë Drejtori dhe Bordi Këshillimor.¹⁶⁷

Prioriteti kryesor i ASPA është formimi profesional i nëpunësve të administratës publike ku përfshihen:¹⁶⁸

- i. trajnimi i detyrueshëm në periudhën e provës për nëpunësit civilë;
- ii. trajnimi për zhvillimin e karrierës së nëpunësve të administratës publike;
- iii. trajnimi për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, sipas nenit 24 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”;
- iv. trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta për nëpunësit e administratës publike;
- v. trajnimi për zhvillimin e njohurive profesionale për nëpunësit e administratës publike.

Në vitet e fundit (2010- 2013) Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP), institucioni paraardhës i ASPA ka raportuar disa aktivitete ndërgjegjësuese dhe trajnime për etikën, konfliktin e interesit dhe antikorrupsionin.¹⁶⁹ Në përgjithësi, këto aktivitete janë organizuar në kuadër të projekteve të mbështetura nga OSBE, USAID dhe Delegacioni i BE në Tiranë.¹⁷⁰ Ndërmarrja e këtyre aktiviteteve, me përfshirjen pothuajse ekskluzive të donatorëve, nuk ka mundur ende të sjellë si rezultat ngritjen e kapaciteteve dhe burimeve të qëndrueshme për të ndjekur në mënyrë efikase zbatimin e ligjit.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPAP)¹⁷¹ në raportin vjetor të vitit 2014 prezanton një numër trajnimesh mbi etikën të kryera gjatë vitit 2014.

165 Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 8/1

166 Po aty. Neni 8/2

167 VKM Nr. 220, datë 13.02.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Trajnimit të Nëpunësve të Administratës Publike”, 4

168 VKM Nr. 220, datë 13.02.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Trajnimit të Nëpunësve të Administratës Publike”, 2

169 Raporte të DAP 2010, 2011, 2012, dhe 2013, të disponueshme në <http://dap.gov.al/dokumenta/raportet-vjetore>, aksesuar në shtator 2014

170 Raport i Veprimtarisë së ASPA-s për vitin 2014

171 Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 8; dhe Vendimi i KM nr. 138, datë 12.3.2014, Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimit e nëpunësve civilë.

Raporti thekson rëndësinë e trajnimeve lidhur me këtë çështje. Pjesë e trajnimit të përgjithshëm, 'Prezantimi me Administratën Publike', kanë qenë edhe trajnimet për çështjet e konfliktit të interesit dhe korrupsionit në administratën publike, të cilat janë kryer në nivel qendror dhe lokal. Raporti nuk jep një numër të caktuar në secilën prej trajnimeve për etikën si dhe tema të lidhura me të, por bazuar në Shtojcën 1 të Raportit, Tabela 4 më poshtë paraqet një përmbledhje të temave trajnimeve për çështjet e etikës.

Raporti nuk jep një numër të caktuar vetëm mbi trajnimet mbi etikën, por bazuar në Aneksin 1 të Raportit, Tabela 4 më poshtë prezanton një përmbledhje të temave të trajnimeve mbi çështjen e etikës.

Tabela 4: Trajnime mbi Etikën, Konfliktin e Interesit dhe Korrupsionon zhvilluar në vitin 2014

Tematikat e Trajnimeve	Numri i Trajnimeve
Çështje të Etikës në Administratën Publike	5
Etika dhe Konflikti i Interesit në Administratën Publike	2
Çështje të Etikës dhe Antikorrupsionit në Administratën Publike	15
Gjithsej	22


4.2. Infrastruktura etike

Për zbatimin, promovimin dhe nxitjen e vlerave dhe standardeve etike, duhet të ekzistojnë disa dispozita të rëndësishme.

4.2.1. Trajnime mbi Etikën

Çështja e zhvillimit të trajnimeve mbi etikën u diskutua më sipër, por shkurtimisht është adresuar përsëri duke pasur parasysh rolin e saj në zbatimin e mekanizmave të etikës. Trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil mbi çështjet e etikës janë instrumente të nevojshme për t'i informuar dhe për të rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi proceset etike. ASPA në raportin vjetor të vitit 2014 jep numrin e përgjithshëm të trajnimeve dhe atë të nëpunësve civilë të trajnuar. Sa i përket institucioneve të tjera që kanë miratuar kode etike profesionale nuk ka të dhëna në dispozicion për këtë çështje.

Grafiku 1. Shpërndarja dhe tematika e kurseve të trajnimit të organizuara nga ASPA në vitin 2104



Burimi: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Raporti i Veprimtarisë së ASPA-s për vitin 2014

4.2.2 Komunikimi i vlerave dhe parimeve themelore etike

Në lidhje me zbatimin e etikës nga ana e nëpunësve publikë, njësitë e personelit të institucioneve përkatëse janë të detyruara ti bëjnë të ditur nëpunësve në çastin e punësimit detyrimet që rrjedhin nga ligji¹⁷² dhe që duhen respektuar nga ato. Kjo nënkupton që vlerat thelbësore të paraqitura mbi etikën bëhen të njohura kur dikush bëhet pjesë e shërbimit publik.

Në rastet kur punonjësi është i pasigurt për vepruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ai/ajo duhet të kërkojë këshilla nga njësia e personelit të institucionit.¹⁷³

Dispozitat e këtij ligji janë pjesë e kushteve të punësimit të të punësuarit,¹⁷⁴ që nënkupton se të gjithë të punësuarit në sektorin publik sipas dispozitave të këtij ligji duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të informuar mbi parimet dhe të gjitha dispozitat e tjera që kanë të bëjnë me çështje të etikës të rregulluara nga ky ligj. Autoriteti përkatës përgjegjës për zbatimin e dispozitave të përmendura më lart është eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit të administratës publike, i cili ka përgjegjësinë për të kontrolluar nëse nëpunësit janë duke zbatuar rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe të propozojë ose të marrë masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.¹⁷⁵ Aktualisht nuk ka qenë e mundur të merren të dhëna të sakta në lidhje mënyrën e komunikimit të etikës, normave dhe parimeve tek nëpunësit publikë, përveç se sa parashikohet në ligje ose kode të etikës.

¹⁷² Ligji Nr. 9131, date 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Neni 18

¹⁷³ Po aty.

¹⁷⁴ Po aty.

¹⁷⁵ Po aty.

Format e komunikimit të vlerave etike në Shqipëri përfshijnë:

- Janë pjesë e kontratës së punës;
- Njësitë e personelit janë të detyruara t'ja bëjnë të njohura të punësuarit;
- Nëpunësi kërkon/konsultohet me njësinë e personelit;
- Janë krijuar Manuale mbi Etikën, të cilat shpërndahen tek punonjësit;
- Vlerat etike publikohen brenda mjediseve të institucioneve

4.2.3. Rekrutimi

Përzgjedhja e stafit është një faktor vendimtar për rritjen e integritetit në sektorin publik. Pjesë e procesit të përzgjedhjes duhet të mbulojë gjithashtu njohuritë mbi etikën dhe integritetin nga kandidatët kërkojnë të punojnë në shërbimin publik. Në Shqipëri, në mënyrë që kandidatët të bëhen pjesë e shërbimit civil janë të detyruar të kalojnë në një provim hyrës, i cili synon vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkursi kombëtar, që përfshin një test me shkrim, një test me gojë dhe forma të tjera për verifikimin e aftësive si dhe vlerësimin e formimit profesional të kandidatëve.

Pjesë e këtij procesi të përzgjedhjes është njohja mbi instrumentet ligjore kryesore që sigurojnë transparencë dhe rregullojnë normat etike, sepse legjislacioni më poshtë mbi etikën është i përfshirë në pjesën më të madhe të kërkesave në testet e provimit për rekrutimin e nëpunësve publikë.

- Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”;
- Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, (Fletore Zyrtare 19/1999, faqe 578; data e publikimit: 20.07.1999);
- Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”;
- Ligji Nr. 8503, datë 30.06.1999
- Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”
- Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”

4.2.4. Krijimi i strukturave të etikës

Në Shqipëri mungojnë strukturat e etikës që koordinojnë e monitorojnë zbatimin e përgjithshëm të legjislacionit dhe infrastrukturës etike. Nevoja për të ngritur këto struktura në administratën në nivel qendror e vendor është shumë e rëndësishme. Një mundësi t'u shqyrtuar është ngritja e një agjencie ose departament të specializuar e mandatuar për të mbikëqyrur etikën në tërë shërbimin publik.

- Këto struktura shërbejnë për të koordinuar dhe mbështetur të gjithë elementët e tjerë të infrastrukturës;
- Ato veprojnë edhe nëpërmjet zbatimit indirekt të nismave etike ose duke deleguar këtë detyrë tek departamentet ose agjencitë e tjera;
- Zakonisht këto struktura mund të kryejnë funksione të tjera në lidhje me këshillimin dhe promovimin e etikës.

4.3 Zbatimi i kodeve të etikës

4.3.1 Zbatimi i kodeve të etikës miratuar me ligj

Pavarësisht faktit që Kodi i Etikës së Policisë është kodi i parë i etikës i miratuar në vend me ligj faktit që lufta kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit është konsideruar si një prioritet i rëndësishëm, zbatimi i tij ka qenë i dobët dhe i pjesshëm. Kodi i Etikës së Policisë ka shërbyer pak ose aspak në veprimtarinë e përditshme të Policisë e Shtetit dhe njohja e kodit nga punonjësit e policisë është e dobët.¹⁷⁶ Ky kod është shembulli më i mirë për të ilustruar se si një dokument edhe pse i miratuar me ligj dhe i detyrueshëm për zbatim ka gjetur zbatim të dobët për shkak të hartimit të dobët të përmbajtjes, komunikimit të dobët dhe mungesës së infrastrukturës së nevojshme për ta zbatuar.

Ligji 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” u miratua për dy qëllime kryesore: 1) Për të futur etikën në shërbimin civil, 2) Për të shërbyer si bazë për miratimin e ligjeve më specifike dhe të detajuara për etikën nga segmente të ndryshme të administratës publike.¹⁷⁷ Në Ligjin “Për Nëpunësin Civil”, shkeljet e përsëritura të rregullave të etikës në shërbimin civil konsiderohen si shkelje të rënda.¹⁷⁸ Në lidhje me zbatimin e ligjit për rregullat e etikës në administratën publike, i cili ishte objektivi kryesor i ligjit gjatë kohës së miratimit të tij, analiza e raporteve të Departamentit të Administratës Publike (DAP) për periudhën nga viti 2006

176 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Integriteti Policor dhe Korrupsioni në Shqipëri, Tiranë 2014. f. 63-65, 95

177 Raporti Vjetor i DAP 2003, <http://dap.gov.al/dokumenta/raportetvjetore/65-raporti-vjetor-dap-2003>

178 Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 57/3c

deri në vitin 2013 nuk tregojnë të dhëna të rëndësishme për zbatimin e tij. Raportet e viteve të hershme (2003- 2004) nënvizojnë rëndësinë e ligjit, por nuk janë raportuar rezultatet e zbatimit, ndërsa për disa vite (2005- 2009) mungojnë të dhënat në lidhje me këtë.

Ligji "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike" përfshin edhe masat disiplinore, të cilat, siç përcakton ligji,¹⁷⁹ zbatohen sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin për nëpunësin civil. Masat disiplinore përfshijnë: vërejtje; mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj; pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pages për një periudhë deri në dy vjet; largimin nga shërbimi civil.¹⁸⁰ Tabela e mëposhtme paraqitet një përmbledhje të masave disiplinore për nëpunësit civilë përgjatë periudhës 2006-2013, siç raportohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) (Tabela 5).¹⁸¹

Tabela 5: Masat Disiplinore për nëpunësit civilë për periudhën 2003-2013

Viti	Largim nga Shërbimi Civil	Pezullim deri në 2 vjet nga e drejta e ngritjes në detyrë	Ulje në Detyrë	Vërejtje me shkrim	Vërejtje me shkrim dhe paralajmërim	Total
2002						
2003						
2004						
2005						
2006	27		6	2	10	45
2007	15	1	5	14	14	49
2008	10			10	3	23
2009	6		1	12	6	25
2010	13		2	7	7	29
2011	7	1	1	4	1	14
2012	4		1	3	14	22
2013	15		1	1	6	23

179 Ligji Nr. 9131, date 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Neni 19

180 Ligji Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", Neni 58

181 Të dhënat e marra dhe të prezantuara në tabelën më poshtë i janë referuar periudhës 2003-2013, kohë në të cilën ishte ende në fuqi dhe aplikohet Ligji Nr. 8549, date 11.11.1999, " Për Statusin e Nëpunësit Civil"

Viti	Largim nga Shërbimi Civil	Pezullim deri në 2 vjet nga e drejta e ngritjes në detyrë	Ulje në Detyrë	Vërejtje me shkrim	Vërejtje me shkrim dhe paralajmërim	Total
Total	97	2	17	53	61	230

Burimi: Departamenti i Administratës Publike (DAP) 2003-2013

4.3.2 Zbatimi i kodeve institucionale dhe profesionale të etikës

Ky seksion analizon 32 kode të etikës, miratuar në sektorë të ndryshëm, të cilat janë gjetur në kohën kur studimi është kryer. Në shumicën e rasteve kodet e etikës janë gjetur duke kërkuar për përmbajtjen e tyre në faqen e internetit të institucioneve përkatëse.

Gjatë analizimit të përmbajtjes së kodeve të etikës është evidentuar që disa kode janë thjesht deklarata mbi parimet e përgjithshme, pa u fokusuar dhe përcaktuar qëllimin e tyre, fushën e veprimit, objektivat, parimet, specifikime të profesionit dhe sanksione. Në këtë mënyrë ka qenë pothuajse e pamundur të kryhet ndonjë vlerësim mbi zbatimin dhe objektivat e tyre. Në përgjithësi këto dokumente janë thjesht deklarata të normave pa synuar të rregullojnë dhe udhëzojnë çështje të lidhura me etikën. Ndërkohë disa prej kodeve të etikës nuk japin ndonjë përcaktim mbi etikën ose sjelljen etike. Mund të arrihet në përfundim që pjesa më e madhe e parimeve të përgjithshme siç parashikohet në Ligjin për Etikën janë miratuar në kodet e etikës së institucioneve respektive. Një qasje e plotë dhe konsistente etikës dhe infrastrukturës në sektorë specifikë mungon, si p.sh. kodi i etikës për sistemin bankar ose një kod i etikës për qeverisjen vendore.

Diskutim në Fokus Grup: Pjesa më e madhe e kodeve të etikës miratuar në Shqipëri ndajnë të njëjtat vlera themelore, të tilla si paanësia, ligjshmëria, integriteti, transparenca, efiçenca, barazia, përgjegjshmëria dhe drejtësia. Ndërkohë nevoja për të standardizuar disa prej kodeve të etikës do të ishte shumë e rëndësishme, si psh. duke miratuar kode etike sektoriale në profesione ose institucione specifike.


Nga ana tjetër, ka pak ose aspak të dhëna sistematike dhe të disponueshme lidhur me zbatimin e kodeve të etikës.

Diskutim në Fokus Grup: Gjatë diskutimeve të fokus grupit është evidentuar që të dhënat në lidhje me zbatimin e kodeve të etikës të analizuara ndryshojnë, por në përgjithësi ka shumë pas ose aspak informacion. Një përqindje e vogël e nëpunësve të administratës shtetërore të cilët mbulohej nga Ligji për rregullat e etikës kanë ndjekur trajnime mbi etikën, gjë e cila tregon që ka një mungesë të ndërgjegjësimit mbi nevojën për të trajnuar nëpunësit mbi etikën dhe gjithashtu një mungesë të interesit nga nëpunësit për të ndjekur këto trajnime.

Analiza e kodeve të etikës në Shqipëri mund tregon se përveç Kodit të Etikës së Policisë,¹⁸² dhe Ligjit për Rregullat e Etikës në Administratën Publike,¹⁸³ asnjë kod tjetër etike nuk është miratuar me ligj.

Pjesa më e madhe e Kodeve të Etikës janë miratuar me vendime ose urdhra të drejtuesve të institucioneve dhe në raste të tjera me akte të lëshuara nga Bordet, Asambletë, Këshillat ose Senatet. Në raste të tjera, siç evidentohet edhe në Aneksin në fund të studimit, akti ligjor i përdorur për të miratuar kodin është i paqartë, i panjohur ose i paspecifikuar.

Grafiku 2. Baza ligjore e kodeve të etikës



I njëjti problem është evidentuar edhe në rastet kur është analizuar akti ligjor mbi etikën i miratuar nga organet vendore (bashkitë). Një prej kodeve adreson rregullimin e etikës siç përcakton Ligji mbi Etikën në Administratën Publike (p.sh., Bashkia e Dibrës), ndërkohë që tre bashki të tjera kanë miratuar kodet e tyre të etikës (Bashkitë e Shkodrës, Bilishtit dhe Korçës) për të rregulluar çështjet e etikës duke i nxjerrë në rregulloret e tyre të brendshme.

182 Ligji Nr. 8291, datë 25.02.1998, "Për Kodin e Etikës së Policisë"

183 Ligji Nr. 9131, datë 8.09.2003, "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike"

Diskutim në Fokus Grup: Në vitin 2002 nëpërmjet një nisme të Këshillit të Bashkive të Shqipërisë rregullat e etikës u miratuan si pjesë integrale e rregulloreve të tyre të brendshme. Ndërkohë në vitin 2005 u miratua nga të gjitha Bashkitë në Shqipëri “Pako e Iniciativave Model”, e cila ofron udhëzime dhe këshilla mbi çështjet dhe problemet që lidhen me etikën. Megjithatë pjesa më e madhe e bashkive të Shqipërisë nuk iu përgjigj propozimit të Këshillit të Bashkive.

Në lidhje me mekanizmat e sanksioneve në rastet e shkeljeve etike analiza tregon që mungon një qasje ose sistem i standardizuar. Disa prej kodeve të etikës i referohen masave disiplinore siç përshkruhen në Ligjin “Për Nëpunësin Civil”, “Kodin e Punës” ose në rregulloret e brendshme. Kode të tjera të etikës i referohen masave disiplinore bazuar në ligjin organik përkatës, ndërsa disa kode të tjera etike nuk parashikojnë fare mekanizma sanksionesh.

Të dhënat e lartpërmendura tregojnë për mungesën e një qasje të qartë dhe të unifikuar ndaj etikës dhe mungesa e të dhënave në lidhje me zbatimin e sanksioneve është një tjetër tregues i zbatimit ose ndikimit të dobët të këtyre kodeve.

Për kodet e etikës të cilat i referohen Ligjit “Për Nëpunësin Civil” në rastet e shkeljeve etike, DAP është institucioni përgjegjës për shqyrtimin dhe mbajtjen e të dhënave dhe informacionit mbi këtë çështje. Megjithatë DAP nuk specifikon në raportet e tij vjetore numrin e masave për shkelje të cilat lidhen me etikën.

Diskutim në Fokus Grup: Në mjaft raste ekzistenca e mekanizmit të sanksioneve është konsideruar një pjesë jo detyruese e kodeve etike duke patur parasysh faktin që ato mund ti referohen legjislacionit ekzistues. Etika është konsideruar më tepër se sa një çështje strikte dhe formale e cila ka nevojë të rregullohet, një vlerë e brendshme e nëpunësve dhe drejtuesve brenda një organizate. Nevoja për ta rregulluar dhe institucionalizuar atë tregon që ekziston një problem në lidhje me qasjen drejt përbrendësisimit të etikës në institucionet respektive.

Institucione të tjera kanë krijuar struktura specifike mbi etikën, të cilat shërbejnë për të identifikuar dhe trajtuar çështjet etike, p.sh., të ashtuquajturat këshilla etike ose komitete etike, të krijuara në pjesën më të madhe në sektorin e arsimit. E njëjta gjë mund të thuhet për institucione të tjera, të cilat kanë krijuar struktura specifike që kanë të bëjnë me rastet e shkeljeve etike. Kodet e Etikës të miratuara në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë e kanë adresuar këtë çështje duke iu referuar këshillave të etikës, komisioneve të etikës ose strukturave të ngjashme. Megjithatë edhe në këto raste nuk ka qenë e mundur të merren të dhëna nga këto institucione ose struktura përkatëse në lidhje me zbatimin e kodeve të etikës.

Focus Group Discussion: Mungesa e një autoriteti në të gjitha nivelet për të mbikëqyrur etikën është një çështje që duhet të adresohet dhe diskutohet më gjerësisht. Komitetet e etikës janë organe ose struktura të miratuara së fundmi në disa vende të rajonit. Së pari, komitetet e etikës mund të shërbejnë për të monitoruar zbatimin e kodeve të etikës. Së dyti, këto organe mund të luajnë një rol aktiv drejt promovimit të kodeve të etikës dhe zhvillojnë e aplikojnë strategji, të cilat synojnë të rrisin ndërgjegjësimin rreth standardeve etike në shërbimin publik dhe nevojës për të raportuar shkelje.

Një tjetër problem i evidentuar është mungesa e një kodi etik në nivel kombëtar që të mbulojë personat në pozicione drejtuese në strukturat shtetërore (ministra, sekretarë, drejtuesit e autoriteteve). Pozicionet drejtuese janë pjesa më e rëndësishme në testimin e etikës në administratë e në luftën kundër korrupsionit.

Shembuj praktikë të promovimit dhe nxitjes së Etikës në Shqipëri



Urdhri i Infermierit në Republikën e Shqipërisë, Kodi Etik-Deontologjik

Në 2010 institucioni i Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë në bashkëpunim me USAID përgatiti një Dokument Themeltar prej 15.000 kopjesh, i cili përfshinte përveç Ligjit Nr. 9718, datë 19.04.2007 dhe Statutit edhe Kodin Etik-Deontologjik për profesionet e Urdhrit përmendur më lart. Ky Dokument Themeltar është shpërndarë tek të gjithë profesionistët për ti udhëzuar standardet etike të profesioneve të Urdhrit të

Infermierit në Republikën e Shqipërisë.¹⁸⁴



Aktet Ligjore e Nënligjore në Fushën e Konkurrencës–Kodi i Etikës i Autoritetit të Konkurrencës

E njëjta praktikë është ndjekur nga Autoriteti i Konkurrencës në vitin 2011. Ky institucion përgatiti një dokument, i cili përfshinte aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës, duke përfshirë Kodin e Etikës së institucionit (faqe 223). Ky dokument u përgatit me mbështetjen financiare të BE në Shqipëri dhe u shpërndarë tek të gjithë punonjësit e institucionit.¹⁸⁵

¹⁸⁴ Faik Toska, President i "Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë", 4 Shtator, 2015

¹⁸⁵ Vitori Kristo, Drejtorë/Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Integritet Europian, Autoriteti i Konkurrencës, 8 Shtator, 2015

5. Konkluzione dhe rekomandime

Ky studim analizon kuadrin etik që drejton sjelljen e nëpunësve publikë në Shqipëri. Studimi arrin në përfundimin se pavarësisht miratimit të një numri kodesh etike në 15 vitet e fundit, nuk ka një qasje të mirë menduar ndaj etikës e cila të jetë në përputhje dhe reflektojë fazën e zhvillimit, sfidat, nevojat dhe specifikat e administratës publike në Shqipëri. Deri diku edhe për pasojë të sa më sipër niveli i zbatimit është i dobët dhe kjo evidentohet në mungesën e mekanizmave efikase për të siguruar zbatimin e etikës.

Ligji mbi Etikën: Pavarësisht faktit që rregullat e etikës, të parashikuara në Ligjin për Etikën në Administratën Publike shtrihen për organet e administratës publike, siç përcaktohet në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (neni 3/6), disa institucione kanë miratuar kodet e tyre të etikës. Dy shqetësime kryesore mund të evidentohen dhe adresohen në një situatë të tillë. Së pari, ekziston një konfuzion në lidhje me hierarkinë e legjislacionit, krijuar sepse kodet e miratuara të etikës e dublojnë ligjin mbi etikën dhe në këtë mënyrë janë ose të tepërta ose kanë dështuar për të adresuar shqetësime etike specifike institucionale, profesionale ose sektoriale. Së dyti, mungesa e të dhënave për zbatimin e kodeve etike tregon se kontributi i këtyre kodeve është limituar.

Për më tepër, Ligji për Etikën në Administratën Publike i kushton një vëmendje të veçantë çështjes së konfliktit të interesit përveç përcaktimit të udhëzimeve gjithëpërfshirëse mbi etikën, duke krijuar në këtë mënyrë konfuzion ndërmjet përmbajtjes së tij dhe dispozitave të Ligjit për Konfliktin e Interesit. Rrjedhimisht, Ligji mbi Etikën në Administratën Publike do të mund të rishikohet dhe të ndryshohet në mënyrë që të jetë një pjesë integrale e menaxhimit të etikës për administratën publike në tërësi.

Kodet e Etikës: kodet e etikës duhet të shërbejnë si udhëzues për mënyrën se si palët e përfshira pritet të veprojnë dhe të sillen reciprokisht dhe ndaj mjedisit të tyre. Në këtë mënyrë kodet e etikës janë deklarata të parimeve mbi të cilat bazohet dhe kryhet misioni dhe vlerat e institucionit. Disa nga kodet e analizuara të etikës nuk përqendrohen dhe përcaktojnë qëllimin, objektivat, parimet, specifikat e profesionit dhe sanksionet. Në këtë mënyrë është mjaft e vështirë të krijohen konsiderata të sakta mbi zbatimin dhe objektivat e tyre.

Kodet e etikës duhet të bëjnë të qartë objektivin e tyre dhe të ofrojnë udhëzime specifike se si standardet etike duhet të zbatohet dhe të zhvillohen. Ndërkohë një hap i nevojshëm do të ishte krijimi i kodeve sektorial të etikës, duke krijuar në këtë mënyrë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të etikës dhe të infrastrukturës në sektorë të veçantë. Për shembull një kod etike i sistemit bankar, një kod i etikës së pushtetit vendor të miratuar nga të gjitha Bashkitë, etj.

Transparenca: Një problem evident me kodet e etikës në Shqipëri është përhapja dhe komunikimi mbi këto dokumente dhe analiza dhe rishikimi i rezultateve të zbatimit të tij. Pjesa më e madhe e kodeve të etikës në Shqipëri shërbejnë si dokumente formale mbi të cilat pak individë kanë informacion ose nuk kanë informacion të saktë. Në disa raste kjo çështje është më e dukshme duke qenë madje se disa prej kodeve nuk janë botuar apo publikuar në formë elektronike nga institucionet përkatëse. Kjo situatë kufizon njohuritë mbi ekzistencën e këtyre kodeve dhe madje edhe në rastet kur këto kode ekzistojnë ato nuk referohen si dokumente të rëndësishme.

Pavarësisht faktit që kodet e etikës janë miratuar si instrumente për të promovuar çështjet etike ndërmjet anëtarëve të stafit të institucioneve ose ndërmjet tyre dhe palëve të tjera të jashtme, nevoja për të dhënë udhëzime dhe informacion në lidhje me ekzistencën dhe zbatimin e tyre do të krijonte një kuptueshmëri më të qartë të zbatimit dhe brendësimit të tyre. Të gjitha kodet e etikës duhet të publikohen në faqet e internetit të institucioneve dhe seksioneve në faqen dedikuar Departamentit të Burimeve Njerëzore ose strukturave të etikës si Komitetet apo Këshillat.

Infrastruktura e Etikës: Si pjesë e rëndësishme e infrastrukturës etike është edhe krijimi i organeve përgjegjëse për monitorimin e etikës dhe standardeve të integritetit. Në shumicën e rasteve këto struktura mungojnë. Në të tilla raste krijimi i tyre nuk është l domosdoshëm pasi pa këtë infrastrukturë zbatimi i kodeve të etikës është l pamundur.

Një strukturë e konsoliduar përgjegjëse për zbatimin dhe promovimin e integritetit and standardeve etike do të ishte e nevojshme dhe shumë e rëndësishme. Këto

struktura nuk do të shërbenin vetëm për të marrë ankesa mbi shkeljet etike dhe hetimin e rasteve kur rregullat e etikës janë shkelur, por mund të shërbenin edhe si struktura reference për të marrë të dhëna dhe monitoruar në tërësi procesin e etikës në vend.

Mekanizmi i Sanksioneve: Së pari kodet e analizuara të etikës nuk parashikojnë struktura dhe sanksione specifike. Si pasojë në këto raste ka qenë e vështirë të merren të dhëna të saktë në lidhje me zbatimin e kodeve të etikës. Së dyti, në rastet kur mekanizma të tilla sanksionesh janë krijuar në kode në mënyrë formale, mënyra se si këto masa duhen adresuar është e paqartë ose mungon.

Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme që të gjitha institucionet të krijojnë strukturat etike për monitorimin e zbatimit të kodeve të etikës. Në të njëjtën kohë për të shmangur konfuzionin kur adresohen masat disiplinore, referenca ligjore e bërë në rastet e shkeljes së kodit duhet të jetë e qartë dhe e specifikuar si p.sh.,: çfarë legjislacioni duhet të shërbejë si referencë; Ligji “Për Nëpunësin Civil”, Kodi i Punës, Rregullorja e Brendshme ose akte të tjera ligjore.

Hierarkia e Ligjeve: Një tjetër problem me kuadrin e etikës është baza ligjore për miratimin e kodeve e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin dhe brendësimin e etikës. Disa kode janë miratuar me ligj ndërkohë disa të tjerë nëpërmjet vendimeve qeveritare, urdhrave ministrorë, drejtuesve të institucioneve të pavarura ose organizatave profesionale. Si pasojë duket e vështirë të menaxhohet infrastruktura etike me qasjen aktuale. Si rezultat i mungesës së qasje sistematike ose strategjike ndaj etikës, zbatimi është ndikuar gjithashtu negativisht. Kuadri rregullator mbi etikën duhet të sigurojë një kuadër të pajtueshmërisë dhe sanksione dhe në të njëjtën kohë të zhvillojë integritetin institucional dhe vendimmarrjen etike. Si pjesë e kësaj qasjeje duhet të rishikohen një numër i ligjeve dhe kodeve ekzistuese mbi etikën dhe të nxitet zbatimi i tyre.

Infrastruktura Etike: Vizioni dhe objektivat e qarta që duhen arritur nëpërmjet etikës mungojnë. Pavarësisht faktit që në Shqipëri pas viteve 1990 u miratuan instrumentet përgjegjëse, të cilat synojnë të adresojnë çështje të etikës, strukturat e ngarkuara për zbatimin e standardeve etike kanë qenë të pjesshme. Në të njëjtën kohë promovimi i standardeve etike është i pamjaftueshëm dhe udhëzimet për zbatimin e kodeve etike në të gjitha nivelet mungojnë.

DAP dhe autoritete të tjera përgjegjëse duhet të zhvillojnë dhe aplikojnë strategji komunikimi, të cilat të synojnë të rrisin ndërgjegjësimin në lidhje me standardet etike në administratën publike dhe nevojën për të raportuar shkelje të etikës. Numri dhe cilësia e trajnimeve mbi çështjet e etikës nuk është e mjaftueshme dhe duhet rritur, gjithashtu edhe fusha e tyre e veprimit. Është shumë e rëndësishme

që të realizohet një planifikim strategjik i këtyre trajnimeve dhe gjithashtu një strukturë e ngarkuar me monitorimin dhe zbatimin e standardeve etike brenda administratës publike.

Mungesa e një kodi etik për pozicionet e nivelit të lartë drejtues dhe ato politike: Një tjetër problem evident në Shqipëri është mungesa e një kodi etik në nivel kombëtar, i cili do të mbulonte personat të cilët janë caktuar në pozicione të niveleve të larta drejtuese dhe politike në organet shtetërore (ministra, drejtues të institucioneve dhe agjencive të ndryshme në nivel qendror), por nuk i përkasin kategorisë së nëpunësve civilë dhe nëpunësve shtetërorë.

Miratimi i një kodi etik për këtë nivel menaxhimi është një standard ndërkombëtar dhe një mjet i rëndësishëm kundër korrupsionit, i cili ka nevojë të miratohet.

Bibliografia

- Denmark's National Reform Programme. Contribution to EU's Growth and Employment Strategy. The Danish Government, 2005 – <http://www.um.dk/NR/rdonlyres/15E3C091-7A14-493C-82C9-2204B3A9964A/0/TheDanishNationalReformProgramme.pdf>
- Frederickson, H. G. Public Ethics and the New Managerialism: An Axiomatic theory. In H. G. Frederickson and R. K. Ghere (Eds). Ethics in Public Management. Sharpe, 2005.
- Maesschalk, J. The Impact of New Public Management Reforms on Public Servants' Ethics: Towards a Theory. Public Administration, Vol. 82 No. 2, 2004, 465 - 489.
- Bilhim, J., Neves, B. New Ethical Challenges in a Changing Public Administration. Paper presented to the international conference 'Ethics and Integrity of Governance', Leuven, 2005 – http://soc.kuleuven.be/io/ethics/paper/Paper%20WS4_pdf/Joao%20Bilhim_Barbara%20Neves.pdf
- Brady N. F. Public Administration and the Ethics of Particularity. Public Administration Review, Vol. 63, No. 5, 2003, 525 - 534.
- Menzel, D. C. Research on Ethics and Integrity in Governance: A Review and Assessment. Public Integrity, Vol. 7, No. 2, 2005, 147 - 168.
- Cocking, D., Oakley, J. Virtue Ethics and Professional Roles. Cambridge University Press, 2001, pp 2.
- Lewis C.W., Gilman, S.C. The Ethics Challenge in Public Service. Jossey-Bass, 2005, pp 16-17.
- Rohr, J.A. Ethics for Bureaucrats. An Essay on Law and Values. Marcel Dekker

Inc., 1989, pp 68.

Public Service Act and Public Service Code of Ethics. Estonia. 1999. – <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/NISPAcee/UNPAN007216.pdf>, pp 60.

Maesschalk, J. Approaches to Ethics Management in the Public Sector. A Proposed Extension of the Compliance-Integrity Continuum. Public Integrity, Vol.7, No. 1, 2004, 21 - 42.

Building Public Trust: Ethics Measures on OECD Countries. PUMA Policy Brief, OECD, No. 7, 2000.

Ethics in the Public Service. Current Issues and Practice. PUMA Occasional Papers, OECD, No. 14, 1996.

Main features of an Ethics Framework for the Public sector. European Union, 2004.

Principles for Managing Ethics in the Public Service, PUMA Policy Brief, OECD, No. 4, 1998.

Ligje dhe vendime

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”

Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, ndryshuar me Ligjin e ri Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”

Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (Fletore Zyrtare 19/1999, faqe 578; data e publikimit: 20.07.1999), ndryshuar me Ligjin e ri Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë) Ligji Nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare” ndryshuar me Ligjin e ri. Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Ligji Nr. 9049, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

Ligji Nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800 datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855 datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170 datë 22.10.2009, Ligjin Nr. 10309 datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012 dhe Ligjin Nr. 182/2014 “Për Prokurimin Publik”;

Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012 datë 26.04.2012
“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;

Ligji Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Administratës
Shtetërore”

Strategji dhe konventa

Reforma e Administratës Publike, Vlerësimi për Shqipërinë, 2014

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB), Kodi Ndërkombëtar
i Sjelljes për Nëpunësit Publikë, 1996 - <http://www.un.org/documents/ga/res/51/a51r059.htm>

Bashkimi Afrikan, Konventa mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit
- http://www.au.int/en/sites/default/files/AFRICAN_UNION_CONVENTION_PREVENTING_COMBATING_CORRUPTION.pdf

Karakteristikat kryesore të një Kuadri Etik për sektorin Publik. Propozuar nga
Presidenca e Holandës dhe miratuar nga Drejtorët e Përgjithshëm, përgjegjës
për Administratën Publike në shtetet anëtare dhe institucionet e Bashkimit
Evropian në takimin e tyre të 43-të në Maastricht (Holandë) <http://www.eupan.eu/en/documents/show/&tid=48>

Këshilli i Evropës (Komiteti i Ministrave), Rezoluta (97) 24 Mbi 20 Parimet
Drejtuese për Luftën kundër Korrupsionit - <http://polis.osce.org/library/f/2678/487/CoE-FRA-RPT-2678-EN-487.pdf>

Këshilli i Evropës, Konventa e së Drejtës Penale mbi Korrupsionin, 1999 - <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/173.htm>

Këshilli i Evropës, Konventa e së Drejtës Civile mbi Korrupsionin, 1999 <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168007f3f3>

Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Kodi Model i Sjelljes për Nëpunësit
Publikë, 2000,

[https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/documents/Rec\(2000\)10_EN.pdf](https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/documents/Rec(2000)10_EN.pdf)

Këshilli i Evropës, Kodi Evropian i Etikës Policore. Rekomandim Rec(2001)10
miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit Evropian më 19 Shtator 2001
dhe memorandum shpjegues

<http://polis.osce.org/library/f/2687/500/CoE-FRA-RPT-2687-EN-European%20Code%20of%20Police%20Ethics.pdf>

Komunitetit Ekonomik të Shteteve të Afrikës Perëndimore (ECOWAS), Protokoll mbi Luftën kundër Korrupsionit, 2001,

http://www.afrimap.org/english/images/treaty/ECOWAS_Protocol_on_Corruption.pdf

Konventa për Luftën kundër Korrupsionit që ka të bëjë me zyrtarët e Komuniteteve Evropiane ose Zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=URISERV:l33027>

Kodi i Etikës & Standardet e Auditimit

<http://saiwb1.saiuae.gov.ae/Reports/INTOSAI%20Code%20of%20Ethics%20English.pdf>

Organizata e Shteteve Amerikane, Konventa Ndëramerikane kundër Korrupsionit, 1996

<http://www.oas.org/juridico/english/Treaties/b-58.html>

OECD, Konventa për Luftën kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi, 2011

<http://www.oecd.org/corruption/oecdantibriberyconvention.htm>

OECD, Komentet mbi Konventën për Luftën kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi, Nëntor, 1997

<http://www.justice.gov/sites/default/files/criminal-fraud/legacy/2012/11/14/combatabribe2.pdf>

OECD, Rekomandim i Këshillit mbi Përmirësimin e Sjelljes Etike në Shërbimin Publik

<http://www.oecd.org/gov/ethics/Principles-on-Managing-Ethics-in-the-Public-Service.pdf>

Vendim Kuadër i Këshilli mbi Luftën kundër Korrupsionit në Sektorin Privat

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=URISERV:l33201&from=EN>

Komisioni i Komunitetit Evropian, Komunikim mbi një Politikë gjithëpërfshirëse të BE kundër Korrupsionit, 28 Maj, 2003 - <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2003:0317:FIN:EN:PDF>

OECD, Rekomandime të Këshillit mbi Udhëzimet e OECD për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik, Qershor 2003 <http://www.oecd>

[org/gov/ethics/2957360.pdf](http://www.org/gov/ethics/2957360.pdf)

Kombet e Bashkuara, Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme 58/4; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, 31 Tetor, 2003 - <http://www.un-documents.net/a58r4.htm>

OECD, Menaxhimi i Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik (Udhëzime të OECD dhe Përvojat e Vendeve), 2003 - <http://www.oecd.org/gov/ethics/48994419.pdf>

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit - http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50027_F.pdf

OECD, Menaxhimi i Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik (Pakoja e Instrumenteve), 2005 - <http://www.oecd.org/gov/ethics/49107986.pdf>

OECD, Rekomandim i Këshillit për Luftën e Mëtejshme kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi, 26 Nëntor, 2009 - <http://www.oecd.org/daf/anti-bribery/44176910.pdf>

INTERPOL, Standardet Ndërkombëtare për të Luftuar Korrupsionin në Forcat/ Shërbimet e Policisë, 1 Mars, 2008 - <https://ipc498a.files.wordpress.com/2007/07/newsonindianpolicescandals.pdf>

Kodet e etikës

Kodi i Etikës i Bankës së Shqipërisë (BSH), Vendim i Këshillit Mbikëqyrës Nr. 46, datë 25.06.2003

Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), Vendim i Kryetarit të KLSH, Nr. 80, datë 11.07.2005

Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës (AK), Vendim Nr. 69, datë 24.12.2007

Kodi i Etikës i Bashkisë Bilisht, Vendim Nr. 24, datë 11.05.2007

Kodi Etik-Deontologjik, "Urdhrit i Infermierit në Republikën e Shqipërisë", Vendim i Këshillit Kombëtar Nr. 4, datë 8.11.2008

Kodi i Etikës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë

Kodi i Etikës për Ekspertët Kontabël të Regjistruar

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, Urdhri i Mjekëve të Këshillit Kombëtar të Shqipërisë, Vendim Nr. 9, datë 11.11.2011

Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës

Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm, Vendim i Bordit Nr. 119, datë

19.09.2001

Kodi i Etikës dhe Parimet Bazë të Punës së Vëzhguesit Vendor

Kodi i Etikës së Mësuesit në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat

Kodi i Etikës së Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Kodi i Etikës për Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë

Kodi i Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar

Kodi Etik i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP)

Kodi i Etikës i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve

Kodi Etikës i Spitalit Rajonal Durrës

Kodi i Etikës i Universitetit Politeknik të Tiranës

Kodi i Etikës për Administratorët e Falimentit, Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit

Kodi i Integritetit i Entit Rregullator të Ujit të Shqipërisë (ERRU)

Kodi i Etikës dhe Parimet Bazë të Punës së Vëzhguesit Vendor, Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve (INSIZ), 2011

Kodi i Etikës i Medias dhe Personat me Aftësi të Kufizuar

Raporte

Raport Vjetor i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) 2014 http://www.aspa.gov.al/images/raporti_2014.pdf

Commission of the European Communities, Albania Stabilization and Association Report, SEC (2003) 339. http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/2003_progress_report_en.pdf

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2004 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/raportivjetor2004.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2005

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2006 <http://>

Forcimi i Integritetit të Administratës Publike në Shqipëri

dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/raportiVjetor2006.pdf

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2007 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/raportiVjetor2007.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2008 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/Raportivjetor2008.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2009 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/Raportivjetor2009.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2010 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/Raportivjetor2010.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2011 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/Raportivjetor2011.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2012 <http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/Raportivjetor2012.pdf>

Raport Vjetor i Departamentit të Administratës Publike (DAP) 2013 http://dap.gov.al/images/tedhenainst/websitedap/dokumenta%20strategjike/raporte%20vjetor%20Dap/DAP_Raporti_Vjetor_2013_.pdf

Shtojcat

Shtojca 1: Legjislacioni mbi etikën në Shqipëri

Kode etike të institucioneve

Emri i Kodit	Qëllimi	Fusha e Veprimit	Miratuar	Masa Disiplinore
Kodi i Etikës i Autoritetit të Konkurrencës	N/A	N/A	Vendim Nr. 69, datë 24.12.2007	N/A
Kodi Etik i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH)	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 2 (2.1)	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 2 (2.2)	Kapitulli I, Neni 1 i Kodit, Vendim i Kryetarit të KLSH Nr. 80, datë 11.07.2005 (ndryshuar Neni 2 me Vendim Nr. 1, datë 03.01.2012)	Kodi i Punës, Ligji "Për Nëpunësin Civil" – sipas rastit
Kodi i Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar	Në parathënie - Objekti	Në parathënie - Përmbajtje	Urdhër Nr. 90, datë 18.11.2014 i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Fiskale dhe të Ardhurave Publike, Ministria e Financave	Ligji "Për Nëpunësin Civil"

Forcimi i Integritetit të Administratës Publike në Shqipëri

Emri i Kodit	Qëllimi	Fusha e Veprimit	Miratuar	Masa Disiplinore
“Për Kodin e Etikës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”	Neni 1	Neni 1	Urdhër Nr. 274, datë 15.07.2014 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP	Kodi i Punës dhe Rregullorja e Brendshme
Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative i Avokatit të Popullit	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 1	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Nenet 3 & 4	N/A	Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”; Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike (2003)
Kodi i Etikës i ILDKPKI	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 1	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 2	02.09.2014	Kapitulli II, Nenet 13,14-Struktura Mbikëqyrëse e Etikës (Ligji “Për Nëpunësin Civil”, Kodi i Punës, Rregullore e Brendshme)

Shtojca 2: Kodet e Etikës së Praktikës Profesionale

Sektori i shëndetësisë

Emri i Kodit	Qëllimi	Fusha e Veprimit	Miratuar	Masat Disiplinore
Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore		Neni 1	Urdhri i Mjekëve në Republikën e Shqipërisë, Këshilli Kombëtar me Vendim Nr. 9, datë 11.11.2011	Ligji 8615, datë 01.06.2000 "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë" dhe "Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Mjekëve"
Kodi Etik-Deontologjik Urdhri i Infermierit në Republikën e Shqipërisë		Dispozita të Përgjithshme	Miratuar në Këshillin Kombëtar me Vendim Nr. 4, datë 8.11.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 462, datë 13.09.2011, miratuar me Vendim Nr. 43, datë 15.02.2012	Neni 8 – Rregullorja e Gjykimit Profesional; Neni 9 – Sanksione; Neni 10 – Komisioni Qendror i Gjykimit Profesional (Apelim)
Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Farmaceutike	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 1	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 1 & 2	N/A	Rregullore për Komisionet Disiplinore të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë"
Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologëve	Hyrje	Hyrje	Instituti Shqiptar i Psikologjisë; 5 Maj, 2014	N/A
Kodi Etikës i Spitalit Rajonal Durrës	Konsiderata të Përgjithshme (A)	Konsiderata të Përgjithshme (E)	2014-2015	Konsiderata të Përgjithshme (D)

Sektori i arsimit

Emri i Kodit	Qëllimi	Fusha e Veprimit	Miratuar	Masat Disiplinore
Kodi i Etikës i Universitetit Politeknik të Tiranës	Neni 2	Neni 3	Vendim i Senatit Akademik të UPT Nr. 13, datë 11.04.2014	Neni 11, Këshilli i Etikës, 12, 13
Kodi i Etikës së Mësuesit në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat	Neni 3	Neni 4	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Nr. 6222 Prot., datë 12.11.2012	Kodi i Punës, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Dispozitat normative në arsim dhe kontrata kolektive e punonjësve të arsimit. Komisioni i Etikës dhe i Sjelljes – Neni 33 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar
Kodi i Etikës i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 2	Kapitulli I, Dispozita të Përgjithshme, Neni 3	Vendim i Senatit Akademik Nr. 9, datë 01.06.2012	Kapitulli VI, Nenet 24,25,26 Këshilli i Etikës
Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës	Neni 2	Neni 3	Vendim i Senatit Akademik Nr. 12, datë 18.04.2011	Nenet 7, 8 (Këshilli i Etikës), 9, 10
Kodi i Etikës i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë	Kapitulli I, Neni 1	Kapitulli II, Nenet 1,2	08.10.2010 - Bazuar në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë" – Neni 17	Kapitulli IV, Nenet 1-16, Këshilli i Etikës (7 anëtarë nga stafi akademik) dhe Kapitulli V, Nenet 1-3
Kodi i Etikës i Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit	N/A	N/A	N/A	Përcakton veprimet të cilat përbëjnë shkelje etike, por nuk specifikon masat dhe organet për trajtimin e sanksioneve

Kode të tjera etike

Emri i Kodit	Qëllimi	Fusha e Veprimit	Miratuar	Masat Disiplinore
Kodi i Etikës së Policisë	Neni 1	Neni 1	Ligji Nr. 8291, datë 25.02.1998	Nenet 8, 14, 16 Komisioni Disiplinor
Kodi i Etikës i Bankës së Shqipërisë (BSH)	Konsiderata të Përgjithshme (A)	Konsiderata të Përgjithshme (E)	Vendim i Këshillit Mbikëqyrës Nr. 46, datë 25.06.2003	Konsiderata të Përgjithshme (D)
Kodi Etik i Avokatit	Përcaktuar në Parathënie	Përcaktuar në Parathënie	Vendim Nr. 31 i Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatëve në datë 12.11.2005	Ligji "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatëve
Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)	Hyrje	Hyrje	Vendim i Bordit Nr. 119, datë 19.09.2011	N/A
Kodi i Etikës për Ekspertët Kontabël të Regjistruar (EKR)	Vendos kërkesat etike të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë ekspertët kontabël të regjistruar profesionistë, anëtarë	Të gjithë anëtarët e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA)	Ndryshuar me Vendim të Asamblesë Nr. 76, datë 30.06.2010 dhe miratuar nga BMP me Vendim Nr. 31, datë 08.09.2010. Miratuar nga BMP me Vendim Nr. 21, datë 24.04.2012	Po, investigime dhe procedime disiplinore
Kodi i Etikës për Inspektorët Financiarë Publikë	Po, përcaktuar në Kod	Po, përcaktuar në Kod	Urdhër Nr. 8, datë 13.02.2013, Ministria e Financave	Po, kundërvajtje administrative, zbatohen sanksione përkatëse ligjore
Kodi i Etikës për Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë	Kapitulli II	Kapitulli II	N/A	Kapitulli IV – Rregulloret e Brendshme & aktet ligjore ne fuqi

Forcimi i Integritetit të Administratës Publike në Shqipëri

Emri i Kodit	Qëllimi	Fusha e Veprimit	Miratuar	Masat Disiplinore
Kodi i Etikës për Administratorët e Falimentit	Po, faqe 3 e Kodit	Po, faqe 3 e Kodit	Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit	N/A
Kodi i Integritetit i Entit Rregullator të Ujit të Shqipërisë (ERRU)	Neni 1	Neni 2	Enti Rregullator i Ujit të Shqipërisë (ERRU)	Komiteti i Integritetit (një përfaqësues nga Sektori Juridik dhe një nga Sektori i Burimeve Njerëzore për një periudhë 1 vjeçare) – Standardet e Procedurave Administrative
Kodi i Etikës dhe Parimet Bazë të Punës së Vëzhguesit Vendor		Vëzhguesit - përcaktuar në faqen 3	INSIZ - Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, 2011	N/A
Kodi i Etikës i Medias dhe Personat me Aftësi të Kufizuar	Kodi përmban vetëm parimet e përgjithshme deontologjike të cilat duhen respektuar	N/A	N/A	N/A